



VOTO
123

PROGRAMI QEVERISËS I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS

Zgjidh
SHPRESEN!

- 12. EKONOMIA DHE FINANCA**
- 14. ENERGJIA**
- 16. DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE**
- 19. INFRASTRUKTURA**
- 21. FAMILJA DHE MIRËQENIA**
- 22. SHËNDETËSIA**
- 23. ARSIMI**
- 25. MBROJTJA**
- 27. RENDI DHE SIGURIA**
- 29. DREJTËSIA**
- 31. INTEGRIMET DHE POLITIKA E JASHTME**
- 33. SPORTI**
- 34. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MJEDISI**
- 36. BUJQËSIA**
- 38. KULTURA**
- 40. ADMINISTRATA PUBLIKE**
- 42. QEVERISJA LOKALE PUBLIKE**
- 44. MËRGATA**
- 46. TREGTIA DHE INDUSTRIA**
- 48. POLITIKA SOCIALE DHE PENSIONALE**
- 50. SEKTORI FINANCIAR**



LUMIR ABDIXHIKU

KANDIDATIT PËR
KRYEMINISTËR

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kosova gjendet sot në një udhëkryq historik. Pas viteve të lodhshme të retorikës së zbrazët, polarizimit dhe shkatërrimit të besimit në institucione, vendi ynë kërkon më shumë se premtime. Kërkon drejtim. Kërkon siguri. Kërkon një udhë të re, të matur, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

LDK-ja e merr sot këtë përgjegjësi me seriozitetin më të lartë shtetëror. Ne e dimë se përballë krizës ekonomike, sociale, institucionale dhe kushtetuese, nuk mjafton vetëm fitorja elektorale; duhet vizion i qartë për qeverisje dhe vendimmarrje. Duhet stabilitet. Duhet besim i ri në shtet.

Këtë program që e ofrojmë para jush nuk e kemi hartuar si listë dëshirash, por si plan pune. Si kontratë me qytetarët. Si udhërrëfyes të vendit për vitet që vijnë. Në thelb të tij, qëndrojnë tre shtylla që përcaktojnë qartë drejtimin tonë politik dhe kombëtar - tri angazhime që LDK i merr përsipër me përgjegjësi dhe përkushtim.

I. Shtylla e parë është Stabiliteti Institucional; themelet e Republikës që duhet të ngrihen menjëherë pas zgjedhjeve për t'i dhënë vendit frymëmarrje, normalitet dhe funksionalitet.

II. Shtylla e dytë është Rimëkëmbja Ekonomike dhe Sociale, për të kthyer zhvillimin në çdo familje, dinjitetin në treg, dhe besimin në mundësinë e jetës këtu.

III. Shtylla e tretë është Orientimi Euro-Atlantik - e vetmja rrugë që garanton siguri, aleanca të forta, integritet evropian dhe paqe të qëndrueshme.

Këto nuk janë vetëm shtylla programore. Janë përgjegjja jonë ndaj thirrjes së Kosovës. Janë udha për rikthimin e shtetit te qytetari. Janë vija të qarta orientimi politik për qeverisjen që vjen.

SHTYLLA I — STABILITETI INSTITUCIONAL

Stabiliteti institucional është themeli i çdo shteti funksional. Pa institucione të ligjshme, të zgjedhura me vullnet demokratik dhe të ndërtuara mbi Kushtetutë, nuk ka zhvillim, nuk ka qeverisje, nuk ka të ardhme. Sot, Kosova e ndjen këtë boshllëk më shumë se kurrë: një vend i lodhur nga improvizimet, nga shkeljet e vazhdueshme kushtetuese për të mbajtur në krye një qeveri jo legjitime, nga përkohshmëria, nga praktikat e kapjes së institucioneve, nga ushtruesit e detyrave që kontrollohen nga politika.

LDK merr zotimin që menjëherë pas zgjedhjeve të sigurojë themelimin e plotë, të ligjshëm dhe të menjëhershëm të institucioneve të Republikës:

- **Konstituimin e Kuvendit të Republikës**
- **Zgjedhjen e Qeverisë së re dhe Kryeministrit**
- **Zgjedhjen e Presidentit të ri të Republikës**

Stabiliteti institucional nis me konstituimin e Kuvendit të Kosovës, zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit dhe kryesisë, duke respektuar plotësisht Kushtetutën, të drejtat e shumicës dhe të drejtat përfaqësuese minoritare; duke ballafaquar guximshëm populizmin dhe duke kuptuar urgjencën kombëtare që vjen nga kriza ekonomike, sociale dhe buxhetore me të cilën po përballlet vendi.

Në këtë proces, LDK angazhohet të udhëheqë me dialog politik, me përgjegjësi dhe me qartësi me palët e tjera. Qeveria e re dhe Kryeministri i vendit duhet të dalin nga një marrëveshje politike e qëndrueshme, transparente dhe kushtetuese - një marrëveshje që i jep vendit sigurinë që i ka munguar.

Po ashtu, për shkak të rrethanave e afateve kushtetuese, LDK merr përsipër të angazhohet në procesin për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, duke garantuar që ky institucion i lartë i vendit të jetë simbol i unitetit, i drejtësisë dhe i përfaqësimit të denjë të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Diskutimet për Kuvend, Qeveri dhe President do të ndodhin në të njëjtën kohë, si pjesë e një teme të përbashkët.

Stabiliteti institucional nuk mbyllet me themelimin e Kuvendit dhe Qeverisë e me zgjedhjen e Presidentit. Ai ka nevojë për vazhdimësi, për rregull, për pavarësi të institucioneve. Prandaj, LDK angazhohet që përmes veprimeve të saj politike të sigurojë:

- **zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me integritet të lartëprofesional e moral, dhe evitim të paralizimit të institucionit më të lartë juridik në vend;**
- **garanci të plotë për zgjedhjen e lirë të Kryeprokurorit të Shtetit, pa ndikim politik dhe me standardet më të larta të pavarësisë;**
- **përmbushjen e të gjitha pozitave vakante dhe heqjen e praktikës së dëmshme të ushtruesve të detyrës që sot, në afër 72% të institucioneve kyçe, ka qenë mjeti kryesor për kapjen politike të shtetit nga pushteti populist.**

LDK merr angazhimin që kjo praktikë të marrë fund. Institucionet e Kosovës duhet t'i shërbejnë ligjit, jo pushtetit. Duhet t'i shërbejnë qytetarit, jo partisë. Ne besojmë se vetëm me institucione të forta, të ligjshme dhe të pavarura, Kosova mund të dalë nga kriza, të rifitojë stabilitetin dhe të ndërtojë të ardhmen e saj evropiane.

Së këndejmi, të gjitha angazhimet pas elektorale të LDK-së, do të drejtohen drejt një konsensusi politik që siguron stabilitet institucional nëpërmjet themelimit, zgjedhjes dhe konsolidimit të institucioneve të lartëpërmendura.

Vlen të theksohet, se kjo shtyllë, përbërja e saj, natyra e partnerëve dhe bashkëpunimeve, përveç urgjencës do të varet ekskluzivisht dhe nga bashkërendimi i pikëpamjeve me dy shtyllat tjera kryesore; në parimin se asgjë nuk është dakorduar derisa gjithçka të jetë dakorduar.

SHTYLLA II – RIMËKËMBJA EKONOMIKE

Rimëkëmbja ekonomike dhe sociale është themeli mbi të cilin ndërtohet e ardhmja e Kosovës. Pas pesë viteve të humbura, pa investime, pa zhvillim dhe pa politike ekonomike, Kosova gjendet në një ngërç zhvillimor që prek çdo qytetar, çdo familje dhe çdo biznes të këtij vendi.

LDK merr sot përgjegjësinë që ta udhëheqë kthesën e madhe të rimëkëmbjes, duke e rikthyer shtetin që ndërton, ekonominë që zhvillohet dhe shoqërinë që ecën përpara. Ne besojmë se Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm, por ky potencial kërkon qeverisje të matur, me vizion dhe me plan të qartë të punës.

Hapi i parë i rimëkëmbjes është ringjallja e investimeve kapitale. Pesë vite pa projekte të mëdha kanë lënë vendin pa zhvillim dhe pa mundësi të reja. LDK angazhohet për një cikël kombëtar të investimeve të mëdha, duke përfunduar të gjitha magjistralet e nisura dhe duke kompletuar rrjetin e autostradave të Kosovës. Unaza e Kryeqytetit, Autostrada e Anamoravës, magjistralet për Pejë, Podujevë, Mitrovicë e Gjakovë janë projekte që nuk presin më. Ato janë jetike për zhvillimin ekonomik, për barazinë rajonale dhe për krijimin e hapësirës së re të rritjes. Investimet kapitale nuk janë asfalt; janë punësim, janë shpresë, janë dinjitet dhe janë themeli mbi të cilin ecën çdo ekonomi moderne.

Në zemër të rimëkëmbjes sonë qëndron edhe zhvillimi teknologjik i vendit. Me rininë më të re në Evropë dhe me potencial të jashtëzakonshëm për të përvetësuar dijet më të avancuara, Kosova ka mundësinë historike të bëhet shoqëri digjitale. LDK do të krijojë kushtet dhe politikat që e shndërrojnë ICT-në në industrinë më të fuqishme të vendit, që hap horizonte të reja punësimi dhe që e sjell ekonominë kosovare në shekullin e ri. Digjitalizimi i administratës, mbështetja e startupe-ve, hapja e qendrave të inovacionit dhe futja e teknologjisë në çdo sektor janë instrumentet që do ta çojnë Kosovën drejt një transformimi të vërtetë ekonomik dhe social.

Një shtyllë kritike e zhvillimit është energjia. Kosova nuk mund të ndërtojë ekonomi të qëndrueshme duke importuar krizë. Vetëm gjatë qeverisjes së fundit, plot 811 milionë euro janë djegur në import të energjisë elektrike = një dëm ekonomik i papranueshëm dhe i rrezikshëm për sigurinë e vendit.

LDK angazhohet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese: centralin e ri me gaz amerikan me teknologjinë më moderne, kapacitetet solare dhe të erës, si dhe rezervuarët energjetikë që stabilizojnë rrjetin dhe sigurojnë furnizim të qëndrueshëm. Me këtë plan, Kosova fiton pavarësi energjetike, çmime më të përballueshme për qytetarët dhe bazën e domosdoshme për zhvillim industrial.

Rimëkëmbja ekonomike dhe sociale nuk ka kuptim pa rimëkëmbjen e arsimit. Fëmijët tanë meritojnë standardet më të larta të shekullit XXI, dhe modeli më i suksesshëm i këtij transformimi tashmë ekziston: mësimi tërëditor. Si një reformë që LDK e solli në Prishtinë dhe e bëri realitet, kjo qasje do të shtrihet në të gjithë vendin si prioritet kombëtar. Mësimi tërëditor përmirëson rezultatet akademike, zvogëlon pabarazitë sociale, ndihmon familjet, i jep fëmijëve më shumë mundësi dhe krijon gjeneratën e re të qytetarëve të arsimuar, të sigurt dhe të gatshëm për tregun modern të punës. Asnjë investim nuk ka kthim më të madh sesa investimi në fëmijët tanë.

Shëndetësia është një tjetër hallkë jetike e rimëkëmbjes sonë. Kosova ka nevojë për shëndetësi moderne, të digjitalizuar, të qasshme dhe të drejtë. LDK angazhohet për ndërtimin e Spitalit të Ri të Kosovës, për vendosjen e sigurimeve shëndetësore dhe për funksionalizimin e sistemit shëndetësor përmes modelit të ndërmarrjes publike - një model që garanton menaxhim profesional, efikasitet dhe shërbime të standardeve të larta. Digjitalizimi i shëndetësisë do të mundësojë transparencë, shërbime më të shpejta dhe trajtim më dinjitoz për secilin pacient të Republikës sonë.

Në përbërjen e rimëkëmbjes sonë qëndron edhe sporti, si pjesë e identitetit, shëndetit dhe krenarisë kombëtare. Kosova do të jetë nikoqire e Lojërave Mesdhetare dhe kjo është mundësi historike për të ndërtuar infrastrukturën sportive të vendit për dekada të tëra. LDK angazhohet për stadiumin kombëtar dhe qendrën e re sportive, stadiumet rajonale dhe për mbështetjen e të gjitha kapaciteteve sportive që i japin vendit tonë jo vetëm garueshmëri, por edhe zhvillim komunitar, social e ekonomik. Sporti është investim në rini, në komunitet dhe në imazhin e Kosovës.

Kjo është rimëkëmbja që propozon LDK: një ekonomi që krijon, një shtet që ndërton, një shoqëri që ecën përpara dhe një vend që i jep mundësi çdo qytetari. Rimëkëmbja ekonomike është premtimi ynë për të kthyer shpresën në Kosovë, për të ndalur emigrimin dhe për ta çuar Republikën drejt një dekade zhvillimi të qëndrueshëm e të drejtë.

SHTYLLA III – ORIENTIMI EURO-ATLANTIK

Orientimi euro-atlantik është shtylla themelore e shtetit tonë modern dhe boshti mbi të cilin është ndërtuar vetë identiteti politik i Republikës së Kosovës. Ky orientim nuk është slogan, as zgjedhje momentale; është projekti më i madh i shekullit tonë dhe garancia e vetme për sigurinë, paqen dhe zhvillimin afatgjatë të vendit. LDK ka qenë forca politike që e udhëhoqi Kosovën drejt botës perëndimore në momentet më të vështira të historisë sonë; dhe sot, kur sfidat e reja të sigurisë dhe gjeopolitikës po rishkruajnë të ardhmen e Evropës, LDK merr përsipër ta udhëheqë Kosovën me të njëjtin vizion, me të njëjtën qetësi dhe me të njëjtën bindje strategjike.

Në këtë rrugë, anëtarësimi në NATO dhe sigurimi i mbështetjes së aleatëve tanë strategjikë mbeten prioritet themelor i politikës sonë të jashtme. Vetëm siguria kolektive euro-atlantike garanton paqen e Kosovës në afat të gjatë. Prandaj qeverisja jonë do ta ndërtojë politikën e jashtme mbi partneritetet e forta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin European dhe vendet kryesore të NATO-s, duke e kthyer konsensusin ndërkombëtar në shtyllë të politikës shtetërore. Kosova sot ka nevojë për rikthimin e besueshmërisë dhe seriozitetit në - për një politikë që flet me partneritet dhe jo me konflikt, me përgjegjësi dhe jo me improvizim, me interes të vendit dhe jo me retorikë boshe.

Rruga drejt Bashkimit European është rruga e vetme politike që i garanton Kosovës zhvillim ekonomik, sundim të ligjit, standarde të larta demokratike dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. LDK angazhohet për përmbushjen e të gjitha kriterëve të procesit të integritetit, për avancimin e reformave në drejtësi, ekonomi dhe administratë publike, dhe për harmonizimin e politikave me standardet europiane. Në një kohë kur Kosova ka humbur vite të tëra në përplasje të kota me partnerët ndërkombëtarë, ne do ta rikthejmë dialogun, respektin dhe aleancën strategjike me BE- në. Ne nuk e shohim integritetin si iluzion politik, por si projekt shtetëror të domosdoshëm, i cili kërkon punë, maturi dhe lidhësi të vërtetë.

Kosova ka nevojë urgjente për të rikthyer besimin e humbur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleatin tonë më të madh historik dhe garancinë kryesore të sigurisë sonë kombëtare. Pezullimi i Dialogut Strategjik me SHBA-në ka qenë sinjali më i rëndë i distancimit të marrëdhënieve tona të jashtme gjatë këtyre viteve. Ky pezullim nuk është teknik; është pasojë politike e sjelljes së papërgjegjshme të pushtetit jolegjitim aktual, që me veprime të pamatura e të papeshuara e ka zbehur besimin amerikan ndaj institucioneve të Kosovës. LDK angazhohet që menjëherë pas konsolidimit të institucioneve të reja, përmes diplomacisë së qetë dhe komunikimit serioz shtetëror, ta rikthejë Dialogun Strategjik me SHBA-në si mekanizmin kyç të bashkëpunimit tonë bilateral. Ky dialog është platforma për sigurinë tonë kombëtare, zhvillimin ekonomik, investimet amerikane, mbështetjen institucionale dhe rrugën tonë drejt NATO-s. Asnjë interes partiak nuk mund të vihet mbi këtë partneritet historik.

Po kaq e rëndësishme është edhe heqja e menjëhershme e masave dhe sanksioneve të Bashkimit Evropian, të cilat sot e mbajnë Kosovën të izoluar politikisht, të dëmtuar ekonomikisht dhe të penalizuar institucionalisht. Këto masa nuk janë vendosur ndaj popullit tonë, por ndaj sjelljes së papërgjegjshme të qeverisë aktuale, e cila ka braktisur partneritetin evropian dhe ka cenuar vlerat e bashkëpunimit ndërkombëtar. LDK merr zotimin që përmes qeverisjes së matur, dialogut të sinqertë me Brukselin dhe respektimit të detyrimeve ndërkombëtare, t'i krijojë Kosovës kushtet për heqjen e plotë të këtyre masave. Vetëm me rikthimin e besueshmërisë së Kosovës në sytë e BE-së, do të hapet rruga për fondet e zhvillimit, për procesin e anëtarësimit në Këshill të Evropës dhe për integrimin e plotë evropian. Evropa është shtëpia jonë politike dhe Kosova duhet të rikthejë vendin e saj të natyrshëm në tryezën evropiane.

Në këtë shtyllë, LDK e trajton me seriozitet të lartë edhe dialogun Kosovë–Serbi. Qëndrimi ynë është i qartë: dialogu është proces i rëndësishëm për integrimin tonë euro-atlantik; dhe i njëjti nuk duhet dhe nuk mund të përdoret për betejat e brendshme politike. Kosova duhet të jetë palë konstruktive, serioze dhe e përgjegjshme, duke mbrojtur interesin e vet shtetëror në partneritet të plotë me aleatët tanë.

LDK zotohet në respektimin e obligimeve ndërkombëtare, në përputhshmëri të plotë me rendin kushtetues të Republikës, sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës dhe karakterin unitar të shtetit të Kosovës. Çdo aranzhim organizativ i brendshëm i Kosovës, do të ketë si pronar të procesit Qeverinë e Kosovës, dhe duhet të ketë si udhëzues të procesit vetëm Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Marrëveshjet e veprimet që tejkalojnë Kushtetutën e Republikës së Kosovës as nuk njihen e as nuk pranohen nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në çdo fazë të dialogut, qëndrimi i LDK-së është i palëkundur: njohja e ndërsjellë është qëllimi final; integriteti territorial dhe kushtetues i Republikës së Kosovës nuk negociohet; dhe çdo marrëveshje duhet të forcojë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, jo ta dobësojë atë.

Një element kyç i orientimit tonë euro-atlantik është politika e jashtme që forcon miqësitë tradicionale të Kosovës dhe i hap vendit rrugë të reja zhvillimi. Ne do të përqendrohemi në zgjerimin e njohjeve ndërkombëtare, në anëtarësimin e Kosovës në organizata multilaterale dhe në fuqizimin e përfaqësimit të vendit tonë në secilin forum global. LDK beson se Kosova duhet të flasë me një zë të qartë, të besueshëm dhe të pjekur; zë që reflekton interesat e shtetit, e jo krizën e ditës. Për këtë arsye, politika jonë e jashtme do të jetë profesionale, e koordinuar dhe e mbështetur në institucione, e jo e personalizuar dhe konfliktuale.

Në këtë shtyllë përfshihet edhe fuqizimi i marrëdhënieve me pesë vendet mosnjohëse të Bashkimit Evropian. LDK angazhohet të punojë me secilin prej tyre për të avancuar procesin e njohjes dhe për të ndërtuar besim të ri politik. Në vend që ta lëndojmë procesin evropian me retorikë të nxehtë, ne do ta çojmë përpara përmes diplomacisë së qetë, dialogut konstruktiv dhe vlerave evropiane që i ka mishëruar LDK që nga themelimi.

Orientimi euro-atlantik është gjithashtu thelbësor për zhvillimin tonë ekonomik. Investimet e huaja, stabiliteti makroekonomik, rritja e eksportit dhe hapja e mundësive të reja për bizneset kosovare varen nga partneritetet me SHBA-në dhe BE-në. LDK do të ndërtojë politika ekonomike që i afrojnë kompanitë kosovare tregjeve evropiane dhe që krijojnë ambient konkurrues për investitorët ndërkombëtarë. Kosova duhet të bëhet vend i besueshëm për investim — vend që garanton siguri juridike, stabilitet politik dhe rregulla të qarta të tregut.

Orientimi euro-atlantik është më shumë se politikë e jashtme — është filozofia jonë e qeverisjes, është identiteti ynë politik, është rruga që ka siguruar lirinë tonë dhe garancia e vetme që mbron të ardhmen tonë. Me LDK-në, Kosova i rikthehet rrugës së vet natyrore: rrugës së aleancës me SHBA-në, të partneritetit me BE-në, të stabilitetit, të pjekurisë shtetërore dhe të integritetit të plotë në familjen euro-atlantike.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Me këto tri shtylla tona - stabilitetin institucional, rimëkëmbjen ekonomike e sociale dhe orientimin euro-atlantik - themelohet boshti politik i qeverisjes sonë të ardhshme. Ato përbëjnë vizionin shtetëror që do ta udhëheqë Kosovën menjëherë pas zgjedhjeve dhe janë përgjigjja jonë e qartë ndaj sfidave më të mëdha të kohës sonë.

Në vazhdim, para jush shpalosim kapitujt kryesorë të programit, të ndërtuar me përkushtim dhe profesionalizëm, që elaborojnë në detaje politikat e çdo sektori: ekonominë, arsimin, energjinë, shëndetësinë, sigurinë, bujqësinë, kulturën, sportin, teknologjinë, diasporën dhe gjithë fushat e tjera strategjike të shtetit tonë. Secili kapitull është hartuar si plan konkret veprimi, si udhërrëfyes i qartë për qeverisjen dhe si kontratë e ndershme me qytetarin.

Por asnjë program, sado i mirë, sado i plotë, sado i ndërtuar me vizion, nuk mjafton vetë. Kosova sot ka nevojë për më shumë se një plan; ka nevojë për një zgjim kombëtar. Për një vetëdije të re se ky vend mund të ndërtohet, se drejtimi mund të kthehet, se e ardhmja mund të fitohet. Ka nevojë për një mobilizim të madh qytetar, për një moment uniteti dhe për një vendim historik që e kthen shpresën në themel të Republikës sonë. LDK është gati ta udhëheqë këtë zgjim. Jemi gati ta marrim përgjegjësinë, ta ndërtojmë shtetin, ta kthejmë stabilitetin, ta ringjallim ekonominë dhe ta rikthejmë Kosovën në rrugën e saj euro-atlantike.

Është koha e Kosovës që zgjohet. Është koha e shpresës që kthehet. Dhe është koha e një udhëheqjeje që e mban fjalën dhe e mban shtetin. Në këtë udhëtim, bashkë me ju, ne e nisim kapitullin e ri të Republikës së Kosovës.

LE TË ZGJEDHIM SHPRESËN!

1 EKONOMIA DHE FINANCA

Ekonomia është themeli mbi të cilin ndërtohet mirëqenia e qytetarëve dhe fuqia e shtetit. LDK paraqet vizionin për një model ekonomik modern, konkurrues dhe të drejtë, që ul barrën tatimore, rrit transparencën dhe krijon kushte të favorshme për investime të brendshme e të jashtme. Qasja jonë synon rritjen e të ardhurave të qytetarëve, përmirësimin e funksionimit të bizneseve dhe forcimin e kapaciteteve të shtetit për menaxhim efikas të financave publike. Përmes reformave fiskale, modernizimit financiar dhe investimeve strategjike, ekonomia kosovare vendoset në një trajektore të qëndrueshme rritjeje, ku sektorët me potencial të lartë, përfshirë turizmin, bëhen motorë të zhvillimit kombëtar.

1.1 Rritje Ekonomike 5-7%

LDK synon rritje reale ekonomike prej 5-7% çdo vit, duke rritur BPV-në nga niveli aktual në 13-14 miliardë euro brenda mandatit. Rritja mbështetet në projekte kapitale publike e private në vlerë miliardëshe dhe në rritjen e eksporteve, sidomos të sektorit IT me vlerë të shtuar të lartë.

1.2 Buxhet 5 Miliardë Euro

Buxheti vjetor i Kosovës synohet të arrijë në 5 miliardë euro deri në fund të mandatit, në raportin historik 1:3 mes buxhetit dhe ekonomisë. Nga 17 miliardë euro buxhet total për katër vjet, rreth 5 miliardë euro do të alokohen për investime kapitale, duke mbajtur normën 30% të buxhetit për investime.

1.3 Koeficient 150

Koeficienti i pagave do të rritet menjëherë nga 110 euro në 150 euro, duke krijuar rritje të menjëhershme të pagave në sektorin publik dhe duke siguruar se asnjë pension nuk bie nën 200 euro. Pjesëmarrja e pagave në buxhet do të jetë rreth 29% në vitin e parë dhe do të bjerë gradualisht falë rritjes së të hyrave nga rreth 5 miliardë euro investime kapitale.

1.4 Pagë minimale 500 euro nga janari

Paga minimale në Kosovë, nga janari i vitit 2026 do të jetë 500 euro. Rritja e pagës minimale nëpër vitet vijuese do të bëhet në konsultim të plotë me Këshillin Ekonomiko-Social duke përfshirë të gjithë akterët e palët me interes në një vendimmarrje të tillë nacionale.

1.5 Punësim i garantuar për 20 mijë të rinj në vjet: subvencionim i pagës prej 500 eurove për secilin të diplomuar të ri në Kosovë; dhe garantim i vendit të punës për 6 deri në 12 muaj.

1.5 Zhvillimi i Qendrës së Skijimit në Brezovicë

Në Brezovicë do të investohen rreth 80 milionë euro, kryesisht përmes PPP-ve, me qëllim zgjerimin e pistave, instalimin e teleferikëve modernë dhe ndërtimin e qendrave hoteliere. Pas investimit, 25% e pronësisë së qendrës mbetet publike, duke garantuar kontroll dhe të ardhura afatgjata për shtetin.

1.6 Zhvillimi i Qendrës së Skijimit në Pejë

Në qendrën e skijimit në Pejë parashihet investim prej 50 milionë euro, duke e shndërruar atë në destinacion turistik gjithëvjetor vetëm 900 metra larg qendrës së qytetit. Projekti do të përfshijë infrastruktura për ski, snoëboarding, çiklizëm dhe turizëm malor, duke gjeneruar dhjetëra mijëra vizitorë në vit.

1.7 Inspektorati i Punës

Numri i inspektorëve të punës do të rritet pesëfish, nga 40 aktualisht në 200 inspektorë, duke mbuluar të gjitha komunat e Kosovës. Qëllimi është mbikëqyrja e zbatimit të normës 40 orë pune në javë, pagesave shtesë dhe kontratave të rregullta për dhjetëra mijëra punëtorë në sektorin privat.

1.8 Aviokompani Kombëtare

Aviokompanisë së parë kombëtare do t'i sigurohet një flotë prej 4 deri në 8 avionësh, me 70 milionë euro investim nga qeveria dhe rreth 100 milionë euro nga partnerët privatë. Synimi është lidhja direkte e Prishtinës me qytetet kryesore të diasporës, duke ulur kostot e fluturimeve për qindra mijëra udhëtarë çdo vit.

1.9 Politikat Tatimore

Pakoja Fiskale 2.0 do të përfshijë masa për mbledhje më efikase të TVSH-së dhe lehtësira për bizneset prodhuese dhe eksportuese, duke ulur informalitetin. Qytetarët do të marrin 2% kthim të TVSH-së në çdo blerje përmes një sistemi QR-digjital.

1.10 Ndryshim i Ligjit të Prokurimit

Ligji i prokurimit do të reformohet për të rritur transparencën dhe efikasitetin, duke eliminuar hapësirat e manipulimit dhe korrupsionit në tenderë. Ndryshimet synojnë t'u japin përparësi kompanive vendore kur ka mundësi, duke përshpejtuar ekzekutimin e investimeve që shpesh bllokohen me muaj e vite.

1.11 Privatizim i Telekomit dhe Liberalizim i Tregut

Telekomi i Kosovës do të privatizohet në masën 51%, ndërsa 49% e aksioneve mbeten publike, duke synuar një treg shumë më konkurrues se sot. Dy vite pas privatizimit, në treg do të hyjnë së paku 2 operatorë të rinj, duke ulur çmimet dhe rritur cilësinë për qindra mijëra konsumatorë.

2 ENERGJIA

Programi politik i LDK-së e trajton energjinë si çështje sigurie kombëtare, stabiliteti ekonomik dhe zhvillim strategjik. Furnizimi i besueshëm dhe i përbalueshëm është thelbësor për qytetarët dhe bizneset, ndërsa mungesa e kapaciteteve të reja ka rritur varësinë nga importi. LDK synon tranzicion të balancuar energjetik përmes kombinimit të burimeve të ripërtëritshme, gazifikimit dhe rritjes së efikasitetit. Mbyllja graduale e termocentraleve të vjetra bëhet e mundur vetëm pas krijimit të kapaciteteve të reja bazë. Programi parasheh investime të mëdha, bashkëpunim rajonal dhe liberalizim të tregut për të ulur kostot dhe për të rritur konkurrencën.

2.1 Ndërtimi i centralit me gaz 500 MW.

Centrali me gaz amerikan krijon kapacitete të qëndrueshme bazë, duke reduktuar varësinë nga importi dhe rrezikun e ndërprerjeve. Me investim rreth 500 milionë euro, ai siguron prodhim modern dhe fleksibil sipas standardeve të BE-së. Ky projekt është shtylla kryesore e stabilitetit energjetik të vendit.

2.2 Gazifikimi i Kosovës.

Linjë nga Hani i Elezit në Mitrovicë (120 milionë €); furnizim nga rrjeti grek përmes Maqedonisë. Linja kryesore e gazit nga Hani i Elezit në Mitrovicë lidh Kosovën me rrjetet rajonale dhe evropiane. Gazifikimi ul kostot për industri dhe familje, duke krijuar bazë për zhvillim ekonomik afatgjatë. Kosova bëhet pjesë e korridoreve moderne të sigurisë energjetike.

2.3 Rehabilitimi i Kosova B.

Rehabilitimi zgjat jetën e termocentralit për 20–25 vjet dhe rrit kapacitetin efektiv në 560 MW. Përmirësimet teknike rrisin sigurinë, efikasitetin dhe performancën mjedisore. Ky projekt siguron furnizim stabil gjatë tranzicionit drejt energjisë së pastër.

2.4 Ndërtimi i 500 MW energji solare.

Investimi në 500 MW kapacitete solare diversifikon burimet e energjisë dhe ul çmimet në afatgjatë. Potenciali i madh natyror bën Kosovën të përfitueshme në mënyrë të qëndrueshme. Projekti zhvillohet me transparencë dhe partneritet të gjerë publik-privat.

2.5 Ndërtimi i 500 MW energji nga era.

Parqet e erës shtojnë prodhimin sidomos në muajt e dimrit kur kërkesa rritet. Ky investim e afron Kosovën me objektivat e energjisë së gjelbër dhe redukton importet sezonale. Energjia e erës është shtyllë e tranzicionit strategjik të vendit.

2.6. Nxitja e prosumers (prodhues-konsumatorë).

Qytetarët dhe bizneset do të mund të prodhojnë vetë energjinë e tyre dhe ta shesin tepriçën në rrjet. Skema nxit kursim, investim dhe rritje të prodhimit vendor. Prosumerët bëhen aktorë aktivë të sistemit energjetik.

2.7. Efiçenca energjetike.

Programet për izolim të ndërtesave, pajisje efikase dhe rinovim të fasadave ulin konsumin deri në 30%. Efiçenca është investimi më i lirë dhe më i shpejtë për siguri energjetike. Kursimet për qytetarët dhe shtetin janë të menjëhershme.

2.8 Infrastrukturë rezervë dhe reversibile.

Investime në bateri dhe hidrocentrale të vegjël (150 milionë € investim publik + 250 milionë € privat). Këto projekte tabilizojnë rrjetin në periudha piku. Këto kapacitete sigurojnë reagim të shpejtë në raste emergjencash. Sistemi bëhet më i qëndrueshëm dhe më i mbrojtur nga luhatjet.

2.9 Plani Kombëtar për vetura elektrike.

Zhvillimi i rrjetit të karikimit dhe stimulimet fiskale nxisin përdorimin e veturave elektrike. Institucionet publike kalojnë gradualisht në flotë të gjelbër. Kosova afrohet me standardet evropiane të mobilitetit modern.

2.10 Zero TVSH në energji për familjarët.

Heqja e TVSH-së ul menjëherë faturat e energjisë për familjet. Kjo masë mbron familjet në periudha të rritjes së çmimeve. Politika është e drejtë, direkte dhe e ndjeshme për qytetarët.

2.11 Dyfishimi i koogjenerimit.

Rritja e kapaciteteve të koogjenerimit ul kostot e ngrohjes dhe rrit efikasitetin. Sistemet moderne reduktojnë humbjet dhe përmirësojnë cilësinë e shërbimit. Prishtina, Mitrovica dhe qytete të tjera përfitojnë nga infrastruktura e re.

3 DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Transformimi digjital është ura që e lidh Kosovën me ekonominë e së ardhmes dhe një nga motorët më të fuqishëm të zhvillimit të saj. LDK paraqet vizionin për një shtet ku teknologjia modernizon qeverisjen, rrit efikasitetin, hap mundësi të reja ekonomike dhe e vendos Kosovën në hartën globale të inovacionit. Qëllimi është krijimi i një infrastrukture të avancuar, përshpejtimi i proceseve digjitale, forcimi i sektorit të TIK-ut dhe zhvillimi i një ekosistemi inovativ që gjeneron vende pune, rritje ekonomike dhe integrim të shpejtë në tregjet digjitale të BE-së. Ky kapitull paraqet një platformë të qartë reformash që e shndërron teknologjinë në një shtyllë të padiskutueshme të modernizimit të shtetit.

3.1 Strategjia e Re Kombëtare për TIK-un

Hartohet strategjia gjithëpërfshirëse për rritjen e sektorit të TIK-ut, forcimin e inovacionit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Arsimi do të përshtatet me nevojat e tregut të punës përmes kurrikulave moderne dhe integritit të aftësive digjitale. Strategjia e re synon rritjen e konkurrueshmërisë së Kosovës në rajon dhe më gjerë.

3.2 Inteligjenca Artificiale në Sistemet Qeveritare

Zbatimi i AI-së në prokurim publik, gjykata, administratë dhe sektorët e tjerë qeveritarë për të rritur shpejtësinë, transparencën dhe saktësinë e proceseve. Sistemet rekomanduese do të personalizohen sipas institucioneve dhe standardeve ligjore. Qasja modernizon mënyrën si funksionon shteti dhe redukton ndjeshëm burokracinë. Themelimi i qendrës Kombëtare për Inteligjencë Artificiale mbetet prioritet.

3.3 Sistemi i Unifikuar Qeveritar për Detyrat dhe Komunikimin

Krijohet platformë e përbashkët për komunikim të brendshëm, koordinim dhe menaxhim detyrash për të gjitha institucionet e vendit. Çdo detyrë e zyrtarëve bëhet e matshme, e gjurmueshme dhe e raportueshme në kohë reale. Sistemi rrit efikasitetin, ul kostot administrative dhe e bën qeverisjen më transparente.

3.4 Reduktimi i Barrës Administrative përmes Digjitalizimit të Legjislacionit

Të gjitha ligjet, udhëzimet administrative dhe procedurat e reja do të hartohen me parimin “digjital në radhë të parë”. Legjislacioni ekzistues do të rishikohet për të larguar pengesat e panevojshme administrative. Kjo reformë e bën shtetin më funksional dhe të përshtatshëm për epokën digjitale.

3.5 Digjitalizimi i Shërbimeve Publike ndaj Qytetarëve dhe Bizneseve

Shërbimet publike do të transformohen në platforma online që ofrojnë shërbime të shpejta, të sigurta dhe transparente. Qytetarët dhe bizneset do të përfitojnë nga procedura më të shkurtra dhe eliminohet në masë të madhe kontakti fizik me administratën. Qasja ul korrupsionin dhe rrit besimin publik.

3.6 Shëndetësia Digjitale

Ndërtohet Sistemi Kombëtar i Informacionit Shëndetësor që përfshin kartelat shëndetësore digjitale, recetat elektronike dhe ndërlidhjen me barnatoret publike e private. Të gjitha spitalet do të pajisen me panele monitorimi në kohë reale. Sistemi rrit sigurinë mjekësore dhe ul kostot operative.

3.7 Arsimi Digjital dhe Integrimi i AI-së në Mësim

Krijohet platformë e unifikuar e menaxhimit të shkollave dhe mësimi online, me kurrikula të digjitalizuara dhe mjete të avancuara të mësimdhënies. Mësimi me inteligjencë artificiale i personalizon përmbajtjet për secilin nxënës. Arsimi bëhet më modern, më interaktiv dhe më i qasshëm.

3.8 Rritja e Aftësive Digjitale në Arsim

Shkollat dhe universitetet pajisen me programe moderne për zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve dhe studentëve. Synimi është përgatitja e një gjenerate të aftë për tregun global të punës. Kjo rrit konkurrueshmërinë e kapitalit njerëzor të Kosovës.

3.9 Qendrat e Inovacionit dhe Startup-et Teknologjike

Krijohen hapësira të dedikuara për inovatorë dhe start-up-e të reja që ofrojnë mentorim, financim dhe mbështetje teknike. Ekosistemi i inovacionit bëhet katalizator për rritjen e TIK-ut. Programet synojnë të prodhojnë kompani të reja që operojnë në tregjet ndërkombëtare.

3.10 Mbështetje për Start-up-et Lokale për Zgjerim Global

Ofrimi i fondeve fillestare, granteve për adoptimin e AI-së dhe programeve speciale për eksport. Startup-et do të lidhen me investitorë, akseleratorë dhe ekosisteme globale për të shpejtuar rritjen e tyre. Objektivi është që Kosova të prodhojë kompani konkurruese në tregjet botërore.

3.11 Financimi dhe Mbështetja për Industrinë TIK

Ofrohen grante, kredi të buta dhe incentiva fiskale për kompanitë e TIK-ut që duan të rriten dhe të eksportojnë. Qeveria mbështet investimet në teknologji të reja dhe kapacitete njerëzore. Qasja synon ngritjen e një industrie të qëndrueshme dhe të orientuar kah inovacioni.

3.12 Rregullimi i Tregut të Teknologjisë dhe Standardet Ligjore

Vendosen rregulla të reja që nxisin konkurrencën, sigurinë dhe investimet në sektorin TIK. Standardet e reja të BE-së për digjitalizim do të adoptohen në legjislacionin vendor. Kjo e bën Kosovën treg më tërheqës për investitorët e huaj.

3.13 Inteligjenca Artificiale dhe Siguria Kibernetike

Hartohen politika të qarta për përdorimin e AI-së dhe krijohen kapacitete të avancuara për sigurinë kibernetike në sektorin publik dhe privat. Do të ndërtohen ekipe kombëtare për mbrojtje nga sulmet kibernetike. Qasja mbron të dhënat dhe infrastrukturën kritike të shtetit.

3.14 Qendrat e të Dhënave dhe Cloud-i Shtetëror

Ndërtohen qendra të reja të të dhënave për ruajtje të sigurt dhe efikase të informacionit publik. Krijohet cloud-i kombëtar për administratë të lehtë, të shpejtë dhe të unifikuar. Ky investim e bën shtetin më të qëndrueshëm dhe më rezistent ndaj rreziqeve teknologjike.

3.15 Programi i Diplomacisë Teknike të Kosovës

Forcohen lidhjet me ekosistemet e BE-së dhe SHBA-së përmes ambasadave, akseleratorëve dhe investitorëve globalë. Qasja e vendos Kosovën në rrugën e integritit teknologjik dhe financiar ndërkombëtar. Diplomacia teknike shndërrohet në instrument të ri të zhvillimit shtetëror.

3.16 Paketa Strategjike “Investoni në Teknologjinë e Kosovës”

Ofron lehtësime tatimore, procedura të thjeshtuara dhe zona të posaçme inovacioni për të tërhequr kompani të huaja. Synimi është sjellja e së paku një kompanie globale Top-20 në Kosovë deri në vitin 2030. Kosova hapet për biznes global dhe për bashkëpunime strategjike.

3.17 Rrjeti i Inovacionit të Diasporës

Aktivizohen profesionistët kosovarë në botë për investime, mentorim dhe bashkëpunim me startup-et vendore. Diaspora bëhet pjesë aktive e ekosistemit të inovacionit. Kjo krijon lidhje të qëndrueshme mes potencialit global dhe zhvillimit lokal.

3.18 Integrimi në Tregjet Digjitale të BE-së

Adoptohen standardet evropiane për nënshkrimet digjitale, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe shërbimet ndërkufitare. Kjo i hap rrugën integritit të plotë të Kosovës në tregun unik digjital të BE-së. Përfitimi final është rritja e konkurrueshmërisë dhe qasjes globale për kompanitë kosovare.

4 INFRASTRUKTURA

Fokusi infrastrukturor i LDK-së përqendrohet në përfundimin e të gjitha magjistrave dhe autostradave të nisura, rritjen e lidhjes mes rajoneve të Kosovës, përmirësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe qarkullimit të mallrave, si dhe modernizimin e rrjetit rrugor, hekurudhor dhe ujësjellës-kanalizimeve. Qëllimi është të mbyllen projektet e ngecura prej vitesh dhe të krijohet një infrastrukturë e qëndrueshme dhe funksionale brenda një mandati qeverisës.

4.1 Përfundimi i të gjitha magjistrave aktuale.

Përfundimi i magjistrave të nisura siguron qarkullim më të shpejtë, ulje të kostove dhe lidhje më cilësore mes qyteteve. Projektet aktuale do të përfundojnë me standarde evropiane dhe me prioritet absolut në mandat. Kjo krijon lehtësim të drejtpërdrejtë për qytetarët dhe bizneset.

4.2 Përfundimi i Magjistrave të Pejës.

Magjistrata e Pejës rikthen funksionalitetin strategjik të këtij korridori perëndimor. Investimi përmirëson sigurinë rrugore, turizmin dhe qarkullimin ekonomik. Projekti do të përfundojë brenda mandatit me cilësi të garantuar.

4.3 Përfundimi i Autostradës së Anamoravës.

Kjo autostradë është investimi kryesor në lindje të vendit, duke lidhur Gjilanin, Kamenicën dhe Vitisë me qendrat ekonomike. Ajo rrit qarkullimin tregtar dhe zvogëlon kohën e udhëtimit për qytetarët. Projekti zhvillon tërë rajonin e Anamoravës.

4.4 Ndërtimi i Unazës së Jashtme të Kryeqytetit.

Unaza e Jashtme lehtëson trafikun brenda Prishtinës dhe krijon lidhje të drejtpërdrejtë me hyrjet kryesore të qytetit. Ajo redukton ndotjen, ul kohën e udhëtimit dhe krijon korridore të reja zhvillimore. Ky projekt është prioritet kombëtar për kryeqytetin dhe kapë një investim prej rreth 300 milionë eurove.

4.5 Ndërtimi i 200 vendndalesave rajonale.

Vendndalesat e reja rrisin sigurinë, orientimin dhe aksesin në transport publik. Ato përmirësojnë udhëtimin ndërurban dhe krijojnë standard të unifikuar në të gjitha komunat. Projekti përfshin pajisje moderne informative dhe aksesueshmëri.

4.6 Vazhdimi i Autostradës “Ibrahim Rugova” deri në Merdar.

Finalizimi i lidhjes me korridoret panevropiane me kusht të mbështetjes financiare të BE-së. Autostrada “Ibrahim Rugova” bëhet korridor strategjik për tregtinë, komunikimin dhe integrimin rajonal të Kosovës.

4.7 Uji dhe ujërat e zeza.

Zgjerimi i investimeve në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit për të mbuluar zonat e pa lidhura deri tani. Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit është themelor për shëndetin publik dhe cilësinë e jetesës. Investimet do të fokusohen në komunat me mungesa kritike dhe në modernizimin e impianteve ekzistuese. Objektivi është furnizim i qëndrueshëm 24/7 për të gjithë qytetarët.

4.8 Infrastruktura hekurudhore.

LDK synon rinovimin e linjave hekurudhore dhe lidhjen e Kosovës me korridoret rajonale të trenave. Transporti hekurudhor ul kostot, ndotjen dhe krijon mundësi të reja për turizëm e tregti. Ky sektor ka rol të rëndësishëm në zhvillimin afatgjatë të vendit.

4.9. Eliminimi i azbestit:

Eliminimi i të gjitha tubacioneve me azbest është prioritet kombëtar për shëndetin publik. Projekti zëvendëson rrjetet e vjetra me materiale të sigurt dhe rezistente. Ky investim përmirëson cilësinë e ujit dhe ul rrezikun e sëmundjeve.

5 FAMILJA DHE MIRËQENIA

LDK e sheh familjen si themelin e Republikës; themelin mbi të cilin ndërtohet e ardhmja dhe fuqia e shoqërisë sonë. Në një kohë kur sfidat ekonomike, sociale dhe demografike po e vështirësojnë rrugëtimin e familjeve të reja, programi ynë vendos prioritetin më të lartë aty ku fillon jeta, siguria dhe shpresa e vendit: tek familja kosovare. Qasja jonë synon rritjen e natalitetit, lehtësimin e barrës financiare, krijimin e kushteve më të mira të jetesës dhe ndërtimin e një arkitekture sociale që i mbron qytetarët në momentet më të rëndësishme të jetës. Përmes politikave konkrete financiare, reformave institucionale dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë, LDK e vendos familjen në qendër të zhvillimit—si motor ekonomik, si shtyllë sociale dhe si garanci e së ardhmes së Kosovës.

5.1 Skema për të posalindurit.

Qeveria e LDK do të mbështesë çdo fëmijë të porsalindur me 200 euro në muaj gjatë vitit të parë të jetës. Kjo përkrahje synon të lehtësojë shpenzimet fillestare të familjeve dhe të nxisë rritjen e natalitetit. Masa është e drejtpërdrejtë, universale dhe synon përmirësimin e mirëqenies familjare.

5.2 Formimi i Ministrisë së Familjes dhe Mirëqenies.

Krijimi i Ministrisë së Familjes siguron koordinim institucional për politikat demografike, sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve. Ky institucion qendror do të hartojë programe afatgjata dhe të qëndrueshme për mbështetjen e familjeve në çdo fazë të jetës. Ai garanton përqendrim të burimeve dhe vizion të qartë shtetëror.

5.3 5000 euro për fëmijën e tretë.

Për nxitjen e rritjes demografike, LDK do të mbështesë çdo familje me 5000 euro për lindjen e fëmijës së tretë. Kjo është një nga masat më të fuqishme financiare në rajon për përmirësimin e natalitetit. Përfitimi ofrohet menjëherë dhe synon stabilitet më të madh për familjet.

5.4 Skema e banimit për familjet e reja.

LDK do të zbatojë programe të posaçme për blerjen ose qiranë e banesës për familjet e reja. Skemat përfshijnë subvencionim të interesave dhe mbështetje për qasje në kredi të lehtësuara. Qëllimi është krijimi i kushteve që çiftet e reja të ndërtojnë jetën e tyre në Kosovë.

6 SHËNDETËSIA

Shëndetësia është një nga shtyllat më të ndjeshme të jetës publike, aty ku qytetari pret siguri, dinjitet dhe trajtim të barabartë. Kosova ka nevojë për sistem shëndetësor që funksionon me profesionalizëm, me pajisje moderne dhe me menaxhim bashkëkohor. LDK paraqet vizion të qartë për transformimin e shëndetësisë në një sistem efikas, transparent dhe plotësisht të digjitalizuar.

6.1 Qendra e Re Spitalore (QKUK e re).

Ndërtimi i një Qendre të Re Spitalore prej 500 milionë euro, në dy faza për 6 vite. Faza e parë përfshinë projektimin, lokacionin dhe ndërtimin fillestar (38 klinikat e reja). Faza e dytë përfshinë instalimin e pajisjeve moderne dhe funksionalizimin gradual të qendrës.

6.2 Specializim dhe punësim i garantuar për çdo të diplomuar.

LDK garanton që çdo mjek i ri do të ketë qasje në specializim dhe vend pune në sistemin publik. Kjo ndal ikjen e profesionistëve dhe siguron staf të mjaftueshëm për spitalet dhe klinikat.

6.3. Sigurimet shëndetësore.

Mbledhjen e premieeve do të nisë së aplikuari që në vitin e dytë të planit tonë, në përmasën e 3.5% nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëmarrësi. Shërbimet e vitit të parë të Fondit, do të mbulohen nga një buxhet i ndarë nga buxheti qendror.

6.4. Sistemi informativ shëndetësor.

Digjitalizimi i sistemit shëndetësor përmes një platforme të integruar prej 30 milion eurosh rrit efikasitetin dhe transparencën. Të dhënat klinike bëhen të qasshme në kohë reale; lehtëson punën e mjekëve dhe pacientëve.

6.5 Pajisje të reja shëndetësore.

LDK parasheh injektim të fuqishëm financiar në blerjen e pajisjeve të reja. Do të ndajmë një fond prej 100 milionë eurove, i cili, për dy vitet e para, do të bëjë blerjen e pajisjeve përkatëse konform nevojave të klinikave dhe spitaleve.

6.6 Menaxhimi i kontraktuar.

Me modelin tonë, për herë të parë ndahen rolet: mjeku nuk do të jetë automatikisht menaxher spitali. Do të angazhohen kompani profesionale për menaxhim të përkohshëm të klinikave problematike.

7 ARSIMI

Arsimi është themeli mbi të cilin ndërtohet e ardhmja e një vendi, fuqia e ekonomisë dhe cilësia e shoqërisë. LDK paraqet një vizion që e nxjerr sistemin arsimor të Kosovës nga stanjacioni i sotëm dhe e orienton drejt standardeve moderne të dijes, inovacionit dhe barazisë. Qasja jonë synon shkolla të modernizuara, mësimdhënie bashkëkohore, digjitalizim të plotë, rritje të cilësisë së mësimdhënësve dhe lidhje të drejtpërdrejtë mes arsimit dhe tregut të punës. Përmes këtij transformimi, arsimi bëhet motor i zhvillimit dhe burim i mundësive të reja për secilin fëmijë, të ri dhe profesionist në Kosovë.

7.1 Mësimi tërëditor në Kosovë.

Implementimi i mësimi tërëditor në secilën komunë të Kosovës. Dy faza implementuese, në të parën, pilot projekti në secilën komunë. Faza e dytë (më shumë se një mandat): implementimi i plotë. Plot 1 miliardë euro për katër vite do të ndahen për këtë projekt madhor kombëtar.

7.2 Ndërtimi i 80 çerdheve të reja.

Qeveria e LDK-së do të rrisë buxhetin për ndërtimin e çerdheve për vit 15 milion euro, me gjithsej 20 çerdhe në vit. Për 4 vite qeverisje do të ndërtohen 80 çerdhe publike të reja me një buxhet prej 60 milionësh.

7.3 Edukimi i hershëm – rritja e përfshirjes.

Rritja e përfshirjes në edukimin parashkollor dhe eliminimi i dallimeve mes zonave rurale e urbane. Kosova mbetet pas standardeve evropiane në edukimin parashkollor, prandaj LDK synon rritje të menjëhershme të përfshirjes. Programet publike dhe bashkëpunimet komunale do ta zgjerojnë qasjen për të gjitha familjet. Edukimi i hershëm është baza e suksesit në arsimin e mëvonshëm.

7.4 Digjitalizimi i shkollave dhe mësimdhënies.

Të gjitha shkollat do të pajisen me teknologji moderne, laboratorë digjitalë dhe qasje në internet të shpejtë. Digjitalizimi përmirëson cilësinë e mësimi dhe e bën arsimin më të aksesueshëm. Nxënësit dhe mësuesit përfitojnë mjete bashkëkohore për zhvillim akademik.

7.5 Zhvillimi profesional i mësimdhënësve.

Programet e detyrueshme të trajnimit dhe certifikimit rrisin cilësinë e mësimdhënies në çdo nivel. Mësuesit do të kenë qasje në kurse bashkëkohore dhe standarde të reja të performancës. Kjo reformë është garancia kryesore për përmirësimin e rezultateve në shkolla.

7.6 Arsimi profesional dhe dual.

LDK do të forcojë arsimin profesional dhe modelin dual në bashkëpunim me industrinë. Kjo rrit punësueshmërinë e të rinjve dhe krijon profil të ri të aftësive në tregun e punës. Shkollat profesionale do të lidhen drejtpërdrejt me bizneset.

7.7 Arsimi i lartë – cilësi dhe hulumtim.

Universitetet do të orientohen drejt cilësisë dhe kërkimit shkencor, me financim të qartë dhe masa llogaridhënieje. LDK synon krijimin e kushteve për hulumtim të avancuar dhe partneritete ndërkombëtare. Arsimi i lartë duhet të jetë motor i inovacionit në vend.

7.8 Akreditimi sipas standardeve ndërkombëtare.

Procesi i akreditimit do të harmonizohet me praktikat më të mira të BE-së. Transparenca, kriteret profesionale dhe vlerësimi i jashtëm sigurojnë besueshmëri dhe cilësi. Kjo reformë e rikthen integritetin e sistemit universitar.

7.9 Forcimi i Fakultetit të Edukimit.

Fakulteti i Edukimit do të reformohet për të krijuar mësues të kualifikuar dhe të përgatitur profesionalisht. Programet e reja dhe praktikat e detyrueshme kthejnë këtë fakultet në qendrën kombëtare të përgatitjes pedagogjike. Ky është investimi më i rëndësishëm për cilësinë e mësimin në vend.

8 MBROJTJA

Mbrojtja është shtylla që garanton sigurinë kombëtare, stabilitetin territorial dhe besueshmërinë e shtetit në arenën ndërkombëtare. Programi ynë paraqet vizionin e LDK-së për ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, modernizimin e pajisjeve dhe infrastrukturës ushtarake, si dhe thellimin e bashkëpunimit me aleatët strategjikë të NATO-s.

8.1 Partneriteti për Paqe dhe Integrimi në NATO.

LDK do të intensifikojë proceset e anëtarësimit në Partneritetin për Paqe si hapin formal drejt NATO-s. Angazhimet politike dhe ushtarake do të harmonizohen me standardet e aleancës.

8.2 Buxhet në mbrojtje konform standardeve të NATO-s.

Mbrojtje e financuar në proporcion të vendeve anëtarë të natës me Bruto Produktin Vendor. Buxheti i mbrojtjes do të rritet gradualisht deri në nivelin që rekomandon NATO. Investimet prioritare do të fokusohen në pajisje moderne, stërvitje dhe rritje të kapaciteteve operacionale.

8.3 Zhvillimi i infrastrukturës ushtarake - kazermat.

Rikonstruktim dhe ridizajnim i objekteve ushtarake dhe ndërtimi i 4 kazermave të reja në Prizren, Gjinoc, Gjakovë dhe Podujevë (investim rreth 60 milionë €). Këto objekte ofrojnë kushte moderne për stërvitje, jetesë dhe operacione të avancuara.

8.4 Vendbanimet për personelin ushtarak.

Për të përmirësuar kushtet sociale të pjesëtarëve të FSK-së, do të ndërtohen vendbanime pranë kazermave. Kjo nxit stabilitetin e familjeve dhe forcën morale të trupës ushtarake.

8.5 Smart Defence.

LDK promovon konceptin e Smart Defence për përdorim më efikas të burimeve mbrojtëse. Bashkëpunimet me aleatët rajonal rrisin kapacitetet teknologjike dhe operacionale me kosto optimale.

8.6 Krijimi i kapaciteteve për operacione ndërkombëtare.

Ndërtimi i njësive të specializuara të gatshme për operacione të paqes dhe ndihmë humanitare (investim rreth 12 milionë €).

8.7 Zhvillimi i kapaciteteve të luftës kibernetike.

Bashkëpunim me SHBA dhe NATO për ngritjen e kapaciteteve elektronike, kibernetike dhe kontrollit të sistemeve EM.

8.8 Programet e tranzicionit për pjesëtarët e FSK-së.

Ofrimi i trajnimeve dhe mundësive të integritit në jetën civile pas pensionimit, përfshirë angazhime akademike dhe institucionale

9 RENDI DHE SIGURIA

Ky kapitull paraqet planin e LDK-së për modernizimin e Policisë së Kosovës, rritjen e kapaciteteve të sigurisë publike, luftimin e krimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërtimin e një sistemi të integruar që garanton mbrojtje efektive për qytetarët. Programi synon një polici profesionale, të pajisur, të trajnuar dhe të afërt me komunitetin, si dhe krijimin e strukturave moderne për parandalim dhe reagim ndaj kërcënimeve të sigurisë.

9.1 Forcimi i Policisë së Kosovës.

LDK synon rritjen e numrit të policëve në 10,000 efektivë për të siguruar mbulim më të mirë territorial dhe reagim më të shpejtë. Modernizimi i pajisjeve dhe teknologjisë rrit efikasitetin operacional dhe sigurinë e vetë personelit. Përmirësimi i menaxhimit dhe planifikimit strategjik garanton performancë më të lartë në terren.

9.2 Rritja e kapaciteteve profesionale të policisë.

Programet e avancuara të trajnimit do të fokusohen në luftimin e krimeve të rënda, krimit ekonomik, terrorizmit dhe kërcënimeve kibernetike. Kjo përgatitje profesionale e bën Policinë e Kosovës më të aftë për të menaxhuar sfidat e kohës moderne. Stafi trajnohet sipas standardeve të BE-së dhe partnerëve ndërkombëtarë.

9.3 Infrastruktura Policore.

Investimet në stacione moderne policore rrisin cilësinë e shërbimit dhe kushtet e punës për policët. Hapësirat e posaçme për viktimat e dhunës në familje garantojnë trajtim dinjitoz dhe mbështetje profesionale. Qasja synon të sjellë infrastrukturë të barabartë dhe të qasshme në gjithë vendin.

9.4 Policia në komunitet.

Modeli i policimit në komunitet forcon marrëdhënien ndërmjet policisë dhe qytetarëve, duke rritur besimin dhe bashkëpunimin. Prania e rregullt në terren dhe dialogu i vazhdueshëm ndihmojnë në parandalimin e kriminalitetit lokal. Ky model e bën Policinë më afër njerëzve dhe nevojave të tyre reale.

9.5 Rregullimi i sistemit të vetingut në polici.

Reforma e vetingut synon transparencë më të madhe, integritet profesional dhe llogaridhënie të brendshme. Procesi i rishikuar siguron që në polici të shërbejnë vetëm individë me integritet të pakontestueshëm. Kjo masë forcon besueshmërinë e institucionit ndaj qytetarëve.

9.6 Bashkëpunimi ndërkombëtar i Policisë së Kosovës.

LDK do të forcojë angazhimin për anëtarësim në EUROPOL, INTERPOL dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë të sigurisë. Bashkëpunimi ndërkufitar rrit kapacitetet për luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit. Integrimi në këto struktura e vendos Kosovën në rrjetet globale të sigurisë.

9.7 Digjitalizimi i shërbimeve policore.

Shërbimet policore do të transformohen në platforma digjitale për të rritur efikasitetin, transparencën dhe qasjen e qytetarëve. Sistemet e integruara mundësojnë menaxhim më të mirë të të dhënave dhe proceseve operative. Digjitalizimi përshpejton reagimin dhe rrit cilësinë e shërbimit.

9.8 Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizmi.

LDK propozon krijimin e një qendre kombëtare për koordinim, analizë dhe parandalim të kërcënimeve nga ekstremizmi dhe terrorizmi. Qendra siguron bashkërendim ndërinstitutional dhe qasje të integruar ndaj rreziqeve. Ajo shërben si mekanizëm kombëtar për mbrojtje të qëndrueshme dhe proaktive.

10 DREJTËSIA

Drejtësia është themeli i shtetit demokratik dhe garancia më e fortë e të drejtave të qytetarëve. LDK synon një sistem gjyqësor të pavarur, profesional dhe efikas, që vepron me integritet dhe jep vendime të shpejta e të drejta. Përmes reformave strukturore, digjitalizimit dhe rritjes së llogaridhënies, ky program synon rikthimin e besimit publik dhe sundimin e plotë të ligjit në Republikën e Kosovës.

10.1 Reformimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial.

LDK do të rrisë transparencën, profesionalizmin dhe standardet e llogaridhënies në të dy këshillat drejtësore. Reformat synojnë përzgjedhje më meritore dhe administrim më efikas të sistemit. Ky riorganizim është thelbësor për pavarësinë e drejtësisë.

10.2 Sistemi i avancuar i performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Do të vendosen matje të qarta të performancës për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sistemi do të monitorojë vonesat, cilësinë e vendimeve dhe standardet etike. Kjo nxit përgjegjësi dhe përmirësim të vazhdueshëm profesional.

10.3 Digjitalizimi i plotë i drejtësisë.

Futja e sistemeve elektronike për menaxhimin e lëndëve, seancave dhe komunikimit gjyqësor rrit efikasitetin dhe transparencën. Arkivat dhe proceset gjyqësore do të kalojnë në platforma digjitale. Kjo e bën drejtësinë më të shpejtë, më të qasshme dhe më të sigurt.

10.4 Gjykatat e specializuara sipas lëndëve.

Do të funksionalizohen dhoma ose gjykata të specializuara për krime ekonomike, korrupsion dhe lëndë të ndjeshme. Këto struktura ofrojnë trajtim profesional dhe të përshpejtuar të rasteve me rëndësi të lartë. Specializimi garanton cilësi më të madhe në gjykim.

10.5 Forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

LDK do të përmirësojë koordinimin ndërmjet policisë, prokurorisë dhe agjencive të tjera për hetime më të thelluara. Fokus i veçantë do t'i kushtohet konfiskimit të pasurisë dhe ndjekjes efektive penale. Kjo qasje synon rezultate të matshme dhe besim më të madh të qytetarëve.

10.6 Reforma në prokurori.

Rritja e autonomisë profesionale dhe specializimi i prokurorëve do të përmirësojnë cilësinë e ndjekjes penale. Menaxhimi i brendshëm do të reformohet për të siguruar efikasitet dhe transparencë më të madhe. Prokuroria bëhet më e pavarur dhe më funksionale.

10.7 Përshejtimi i procedurave gjyqësore.

LDK synon vendosjen e mekanizmave që ulin vonesat dhe rrisin ritmin e trajtimit të lëndëve. Proceset do të thjeshtohen, ndërsa mjetet digjitale do të përdoren për menaxhim më efikas. Objektivi është drejtësia e shpejtë dhe e qasshme për të gjithë.

10.8 Qasja e qytetarëve në drejtësi.

Procedurat gjyqësore do të bëhen më të thjeshta, më transparente dhe më të kuptueshme për qytetarët. Shërbimet publike do të modernizohen për të garantuar trajtim dinjitoz dhe të barabartë. Qasja e përmirësuar rrit besimin e publikut në sistem.

10.9 Ndihma juridike falas.

LDK garanton ndihmë juridike falas për qytetarët me të ardhura të ulëta, duke siguruar barazi para ligjit. Shërbimet do të profesionalizohen dhe zgjerohet mbulimi territorial. Kjo politikë mbron më të cenueshmit dhe forcon drejtësinë sociale.

11 INTEGRIMET DHE POLITIKA E JASHTME

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës është themeli i orientimit tonë strategjik dhe garancia e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit. LDK mbështet një politikë të jashtme të bazuar në vlerat euroatlantike, në partneritetin historik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në integrimin e plotë të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe NATO. Ky kapitull paraqet zotimin e LDK-së për rikthimin e besueshmërisë ndërkombëtare të Kosovës, forcimin e diplomacisë profesionale dhe avancimin e proceseve integruese që kanë stagnuar në vitet e fundit.

11.1 Orientimi euroatlantik dhe partneritetet strategjike.

LDK e përcakton orientimin euroatlantik si shtyllën më të rëndësishme të politikës së jashtme të Kosovës. Partneriteti me SHBA-në, BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar do të thellohet përmes dialogut të rregullt politik dhe bashkëpunimit në siguri. Ky orientim garanton stabilitet të qëndrueshëm dhe forcim të subjektivitetit ndërkombëtar të vendit.

11.2 Marrëdhënia e veçantë me Shtetet e Bashkuara.

LDK angazhohet për rivendosjen e Dialogut Strategjik me SHBA-të dhe për rritjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, reformës në drejtësi dhe zhvillimit ekonomik. SHBA mbetet partneri ynë më i rëndësishëm për pavarësinë dhe sigurinë e Kosovës. Kjo marrëdhënie do të trajtohet si prioritet absolut i politikës së jashtme.

11.3 Integrimi në Bashkimin Evropian dhe zbatimin e MSA-së.

LDK do të rikthejë Kosovën në binarët e integrimit evropian përmes zbatimit të plotë të MSA-së dhe agjendës reformuese të BE-së. Bashkëpunimi me institucionet evropiane do të intensifikohet për të avancuar procesin e anëtarësimit. Qeveria e LDK-së do të shfrytëzojë çdo mekanizëm të BE-së për modernizimin e administratës dhe ekonomisë.

11.4 Rruga drejt NATO-s dhe Partneritetit për Paqe.

Qëllimi strategjik i LDK-së është anëtarësimi i Kosovës në NATO përmes Partneritetit për Paqe si hap i parë. Kosova do të rrisë kontributet në siguri dhe do të forcojë kapacitetet e FSK-së për ndërveprueshmëri me aleatët. Integrimi në NATO siguron paqe afatgjatë dhe mbrojtje kolektive për vendin.

11.5 Rritja e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

LDK do të punojë për njohje të reja ndërkombëtare dhe për anëtarësimin e Kosovës në organizata globale dhe rajonale. Aktivizimi diplomatik do të orientohet drejt shteteve që nuk e kanë njohur ende pavarësinë tonë. Konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar është kusht për forcimin e rolit të Kosovës në politikën botërore.

11.6 Riparimi i dëmeve diplomatike dhe rikthimi i besueshmërisë.

LDK do të normalizojë marrëdhëniet me BE-në duke adresuar pasojat e masave të përkohshme të vendosura ndaj Kosovës. Po ashtu do të punojë për rivendosjen e besimit me SHBA-të dhe partnerët tjerë strategjikë. Diplomacia profesionale do të zëvendësojë improvizimet që kanë dëmton reputacionin e vendit.

11.7 Njohjet e reja dhe pesë vendet anëtare të BE-së.

LDK do të fokusohet fuqishëm në sigurimin e njohjes së Kosovës nga pesë shtetet e BE-së që ende nuk e kanë bërë këtë. Kjo përfshin dialog të koordinuar me partnerët evropianë dhe diplomaci aktive dypalëshe. Njohjet e reja globale do të jenë prioritet i pandalshëm.

11.8 Riorganizimi i institucioneve të politikës së jashtme.

LDK do të rikthejë Ministrinë e Integritit Evropian si institucion kyç për menaxhimin e proceseve të BE-së. Ministria e Punëve të Jashtme do të reformohet për të forcuar shërbimin diplomatik dhe për të rritur profesionalizmin. Qartësimi institucional siguron koordinim të saktë të politikës së jashtme.

11.9 Politikat rajonale dhe marrëdhëniet me fqinjët.

LDK do të promovojë marrëdhënie të mira fqinjësore, stabilitet rajonal dhe bashkëpunim ekonomik. Raportet me vendet e rajonit do të ndërtohen mbi parime të respektit dhe reciprocitetit. Kosova do të jetë faktor konstruktiv në proceset rajonale të integritit.

11.10 Përmbyllja e dialogut me Serbinë me njohje reciproke.

LDK mbështet dialogun me Serbinë si proces që duhet të përfundojë me njohjen reciproke të dy shteteve. Çdo marrëveshje do të jetë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, karakterin unitar të Republikës dhe integritetin territorial të vendit. Qëllimi është normalizimi i qëndrueshëm që garanton paqe dhe integritet evropian.

12 SPORTI

Sporti është një prej fushave me ndikimin më të madh edukativ, social dhe ndërkombëtar për Kosovën. LDK synon masivizimin e sportit, krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e talenteve të reja dhe ndërtimin e infrastrukturës moderne.

12.1 Ndërtimi i Qendrës Kombëtare të Sportit në Prishtinë.

Në katër vite do të investohen mbi 110 milionë euro për Qendrën Kombëtare të sportit, që përfshinë: Stadiumin Kombëtar në Bërnice, Pallatin Kombëtar, Qendrën Sportive dhe Pishinën Olimpikë. Projekti synon standarde të nivelit ndërkombëtar për garat dhe stërvitjet e Kosovës.

12.2 Përgatitja për Lojërat Olimpikë Mesdhetare.

Kosova do të realizojë të gjitha zotimet për organizimin e Lojërave Mesdhetare përmes shfrytëzimit të kapaciteteve aktuale, renovimit të infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimit të objekteve të reja.

12.3 E-Sports Hall.

Ndërtimi i një salle profesionale me kapacitet 3,000 ulëse synon ta shndërrojë Kosovën në qendër rajonale të sporteve elektronike. Objekti do të ofrojë kushte teknike për gara ndërkombëtare dhe evente të mëdha.

12.4 Ndërtimi i 5 stadiumeve rajonale.

Pesë stadiume të kategorive 3 dhe 4 të UEFA-s do të ndërtohen në qendrat kryesore të vendit, me investim prej 12 milionë euro secili. Këto stadiume rrisin kapacitetet e garave profesionale dhe zhvillimit sportiv lokal.

12.5 Fondi Sportiv Shkollor.

LDK do të krijojë fond prej 30 milionë eurosh për rigjenerimin dhe ndërtimin e palestrave shkollore në gjithë Kosovën. Kjo siguron kushte të mira për edukim fizik dhe aktivitet sportiv për nxënësit.

12.6 Themelimi i Ndërmarrjes Sportive.

Do të themelohet një ndërmarrje sportive, potencialisht në partneritet publiko-privat, e cila do të menaxhojë dhe zotërojë objektet sportive kombëtare. Ky model siguron mirëmbajtje profesionale dhe funksionim të qëndrueshëm financiar.

13 PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MJEDISI

Ky kapitull paraqet vizionin e LDK-së për vendosjen e rendit dhe standardeve në ndërtim, modernizimin e planifikimit hapësinor dhe mbrojtjen e mjedisit në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian. Synimi është krijimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të rregullt, duke mbrojtur resurset natyrore, trashëgiminë kulturore dhe të drejtën e qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm. Programi thekson transparencën, harmonizimin ligjor dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale.

13.1 Përditësimi i Planit Hapësinor dhe Hartës Zonale.

LDK synon përditësimin e plotë të Planit Hapësinor dhe Hartës Zonale në përputhje me ligjet e ndërtimit, trashëgimisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Ky proces krijon baza të sakta për zhvillim të rregullt urban dhe rural. Harmonizimi ligjor siguron qartësi dhe shmangje të abuzimeve.

13.2 Themelimi i Eko-Fondit (50 milion €).

Krijohet Eko-Fondi me kapital prej 50 milionë eurosh për pastrimin e Kosovës nga mbeturinat dhe rehabilitimin e zonave të ndotura. Fondi do të financojë projekte komunale dhe ndër- komunale për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave. Qëllimi është rikthimi i mjedisit të pastër dhe rritja e cilësisë së jetës.

13.3 Digjitalizimi i proceseve të lejeve dhe vendimmarrjes.

Lejet e ndërtimit dhe vendimmarrjet urbane do të digjitalizohen për transparencë dhe efikasitet më të lartë. Sistemi digjital eliminon abuzimet, vonesat dhe ndërhyrjet e paautorizuara. Qytetarët dhe bizneset përfitojnë shërbime më të shpejta e më të sigurta.

13.4 Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe resurseve natyrore.

LDK parashikon mbrojtje aktive të trashëgimisë kulturore dhe zonave natyrore në përputhje me standardet e BE-së. Zbatimi rigoroz i kriterëve garanton ruajtjen e identitetit dhe biodiversitetit. Kjo politikë balancon zhvillimin me mbrojtjen e vlerave kombëtare.

13.5 Përfshirja e standardeve të EU Green Deal.

Politikat mjedisore të Kosovës do të përafrohen me EU Green Deal për të mundësuar tranzicion të gjelbër dhe zhvillim të qëndrueshëm. Kjo nënkupton energji të pastër, efikasitet dhe ulje të ndotjes. Aprovimi i këtyre standardeve e afron vendin me BE-në.

13.6 Rishikimi i strategjive sektoriale mjedisore.

Strategjitë për ajrin, ujin, biodiversitetin, mbeturinat dhe ekonominë qarkore do të rishikohen dhe përshtaten me nevojat aktuale. Kjo siguron politika më funksionale dhe realiste për mjedisin. Përditësimi i strategjive rrit koordinimin dhe efektivitetin institucional.

13.7 Forcimi i standardeve kombëtare të mjedisit.

LDK do të përditësojë standardet e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës për t'i përafruar me normat evropiane. Ky proces forcon mbrojtjen e shëndetit publik dhe të ekosistemeve. Standardet e reja sigurojnë monitorim më të saktë dhe masa më efektive për reduktim të ndotjes.

13.8 Ngritja e kapaciteteve inspektuese.

Do të pesëfishohet numri i inspektorëve të ndërtimit, mjedisit dhe planifikimit për të garantuar kontroll efektiv në terren. Rritja e kapaciteteve inspektuese ndalon ndërtimet pa leje dhe ndotjen. Qasja proaktive rrit përgjegjësinë dhe respektimin e ligjit.

13.9 Funksionalizimi i laboratorëve të mjedisit.

Kosova do të forcojë kapacitetet e laboratorëve për monitorimin e cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës. Pajisjet moderne dhe standardet shkencore rrisin besueshmërinë e të dhënave mjedisore. Laboratorët bëhen mjet kyç për politikat dhe masat mbrojtëse.

14 BUJQËSIA

Ky kapitull paraqet vizionin e LDK-së për modernizimin e bujqësisë përmes rritjes së produktivitetit, mbështetjes së fermerëve, zhvillimit të tregut dhe përafrimit me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të Bashkimit Evropian. Qëllimi është krijimi i kushteve më të mira për prodhim, përpunim dhe qarkullim të mallrave bujqësore, duke siguruar rritje të të ardhurave dhe zhvillim ekonomik në zonat rurale. Bujqësia trajtohet si motor strategjik i zhvillimit ekonomik dhe si sektor që garanton sigurinë ushqimore të vendit.

14.1 Subvencionet e bazuara në output.

Qeveria do të kalojë nga subvencionet sipas sipërfaqes në subvencione të bazuara në prodhim, duke rritur efikasitetin dhe vlerën e shtuar në bujqësi. Buxheti për zhvillim rural do të rritet me 100 milionë euro në katër vjet, me fokus tek kulturat eksportuese dhe ato që zëvendësojnë importet. Ky ndryshim synon të nxisë konkurrueshmërinë e fermerëve dhe agrobizneseve.

14.2 Grantet.

LDK do të vazhdojë grantet për mbrojtje të kulturave, ngritje të kapaciteteve grumbulluese dhe përpunuese, si dhe për pajisje bujqësore moderne. Proceset e aplikimit do të thjeshtohen për të hequr barrat burokratike që pengojnë zhvillimin. Qasja e re siguron mbështetje më të drejtë dhe më të shpejtë për fermerët.

14.3 Financimi i normës së interesit.

Përmes FKGGK-së do të krijohet një dritare e veçantë ku qeveria mbulon normën e interesit për kreditë bujqësore, ndërsa bankat mbajnë pjesën tjetër të rrezikut. Kostoja fillestare parashihet të jetë 5 milionë euro, duke u rritur me rritjen e kërkesës për kredi. Ky mekanizëm e ul barrën financiare dhe nxit investimet në ferma dhe agrobiznese.

14.4 Heqja e akcizës në naftë.

LDK do të heqë plotësisht akcizën në naftë për fermerët, duke eliminuar skemat burokratike dhe të paefektshme të rimëkëmbjes. Masa ul drejtpërdrejt koston e prodhimit dhe e bën sektorin më konkurrues. Procesi bëhet i thjeshtë, i drejtë dhe lehtësisht i zbatueshëm.

14.5 Cilësia e ushqimit.

Programi synon garantimin maksimal të sigurisë ushqimore përmes funksionalizimit të laboratorëve dhe kontrolleve të rregullta të produkteve dhe inputeve bujqësore. Harmonizimi me standardet e BE-së siguron cilësi të lartë dhe besueshmëri në treg. Kjo rrit sigurinë ushqimore dhe qasjen në tregjet ndërkombëtare.

14.6 Sistemi i ujitjes.

LDK synon dyfishimin e sipërfaqeve të ujitura nga rreth 20,000 ha në një nivel shumë më të lartë përmes rehabilitimit dhe zgjerimit të rrjeteve të ujitjes. Investimet fokusohen në IbërLepenc, Radoniq dhe akumulimet e reja të ujit, duke shfrytëzuar edhe fondet e IPA-s. Ujitja e qëndrueshme rrit produktivitetin dhe zvogëlon rrezikun nga thatësitrat.

14.7 Sigurimet bujqësore.

Programi synon funksionalizimin e plotë të sigurimeve bujqësore duke subvencionuar deri në 50% të kostos së policave për fermerët. Do të krijohen politika të reja për menaxhim të rrezikut dhe lista e kulturave që përfitojnë nga kjo skemë. Ky mekanizëm mbron fermerët nga humbjet dhe stabilizon prodhimin.

14.8 Pyjet dhe turizmi rural.

Qeveria do të nxisë zhvillimin e turizmit rural, artizanatit dhe bujtinave përmes granteve që mbulojnë deri në 80% të investimeve për bizneset e vogla rurale. Kjo qasje synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin ekonomik të zonave malore. Politikat e diversifikimit e shndërrojnë pyllin dhe natyrën në resurse ekonomike të qëndrueshme.

14.9 Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore.

Qeveria do të ndalë degradimin dhe ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore duke stimuluar përdorimin aktiv dhe produktiv. Parashihen fonde për rregullim të tokave, komasacion, pyllëzim të sipërfaqeve të zhveshura dhe taksime të tokave të pashfrytëzuara. Qëllimi është mbrojtja e potencialit bujqësor të vendit.

14.10 Mbrojtja dhe valorizimi i resurseve pyjore.

LDK synon ndalimin e prerjeve të paligjshme, rehabilitimin e pyjeve dhe ripyllëzimin e zonave të dëmtuara. Legjislacioni do të rishikohet për të mundësuar shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të pyjeve. Masat shoqërohen me fushata ndërgjegjësuese për rëndësinë ekologjike të pyjeve.

14.11 Diversifikimi rural dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Programi mbështet diversifikimin ekonomik të zonave rurale përmes agroturizmit, prodhimit organik dhe zhvillimit të sektorëve tradicionalë. Përfshihet mbështetja e bimëve medicinale, produkteve artizanale dhe përpunimit lokal. Objektivi është rritja e të ardhurave dhe ulja e varfërisë rurale.

15 KULTURA

Kultura është pasuria më e madhe shpirtërore e një kombi dhe themeli i identitetit të tij në botën moderne. LDK paraqet vizionin për zhvillimin, pavarësimin dhe modernizimin e institucioneve kulturore, si dhe për krijimin e hapësirave të reja artistike që i japin energji dhe kuptim jetës kulturore të Kosovës. Qëllimi është forcimi i skenës kulturore, rritja e diplomacisë kulturore dhe mbrojtja e trashëgimisë kombëtare, duke e vendosur kulturën në qendër të zhvillimit shoqëror.

15.1 Teatri i Operas dhe Baletit “Dr. Ibrahim Rugova”.

Ndërtimi i Teatrit të Operas dhe Baletit do të krijojë qendrën më të rëndësishme kulturore të vendit, me investim prej 25 milionë eurosh dhe afat ndërtimi katërvjeçar. Ky institucion do të shërbejë si platformë për artin elitare dhe zhvillimin profesional të talenteve të reja. Projekti ka rëndësi kombëtare dhe simbolike për identitetin kulturor të Kosovës.

15.2 Ndërtimi i objektit të ri të Teatrit Kombëtar të Kosovës.

LDK do të ndërtojë objekt të ri modern për Teatrin Kombëtar, duke krijuar kushte dinjitoze për skenën teatrore të vendit. Objekti aktual do të shndërrohet në Teatrin e Qytetit të Prishtinës me investim prej 10 milionë eurosh. Ky transformim fuqizon prodhimin artistik dhe rrit qasjen e publikut në teatër.

15.3 Ndërtimi i Muzeut të Artit Bashkëkohor.

Muzeu i Artit Bashkëkohor do të krijojë hapësirë të dedikuar për artin modern dhe bashkëkohor, duke promovuar artistët vendorë dhe ndërkombëtarë. Investimi prej 10 milionë eurosh siguron standarde profesionale për ekspozim dhe programim kulturor. Ky institucion e vendos Kosovën në hartën e kulturës bashkëkohore evropiane.

15.4 Themelimi i Qendrës së Librit.

Qendra e Librit do të jetë institucioni qendror për promovimin e letërsisë, bursave letrare, programeve të përkthimit dhe mbështetjes për shkrimtarët. Ajo synon rritjen e qarkullimit të librit dhe forcimin e kapaciteteve krijuese vendore. Ky institucion e afirmon librin si mjet të zhvillimit kulturor dhe arsimor.

15.5 Muzeu i Paqes dhe Rezistencës.

Muzeu i Paqes dhe Rezistencës do të ndërtohet me investim prej 10 milionë eurosh si qendër identitare dhe historike e Kosovës. Ai do të dokumentojë rrugën e popullit të Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Ky muze do të jetë referencë kombëtare dhe ndërkombëtare për historinë tonë moderne.

15.6 Pavarësimi i institucioneve kulturore.

LDK synon rritjen e autonomisë buxhetore dhe funksionale të institucioneve kulturore për të garantuar kreativitet, qëndrueshmëri dhe profesionalizëm. Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Kulturës me plan dhjetëvjeçar siguron zhvillim të planifikuar dhe koherent. Kjo qasje i jep kulturës statusin që meriton në jetën publike.

15.7 Trashëgimia kulturore e Kosovës.

Programi parasheh kujdes të veçantë për trashëgiminë dardane materiale dhe shpirtërore, si dhe funksionalizimin e plotë të parqeve arkeologjike Ulpiana dhe Dresnik. Investimet synojnë ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e vlerave tona historike. Trashëgimia trajtohet si pasuri kombëtare që i përket gjeneratave të ardhshme.

15.8 Qendrat multifunksionale për art dhe kulturë.

LDK do të identifikojë objekte të braktisura me vlerë trashëgimie dhe do t'i rikthejë ato në hapësira kulturore përmes projekteve kreative me komunitetin artistik. Qendrat multifunksionale do të shërbejnë për ekspozita, performanca dhe aktivitete rinore. Kjo politikë rigjallëron hapësirat urbane dhe nxit pjesëmarrjen kulturore.

16 ADMINISTRATA PUBLIKE

Administrata publike është shtylla mbi të cilën qëndron funksionimi i shtetit dhe besimi i qytetarëve në institucionet e tyre. LDK ka vizion të qartë për një administratë moderne, profesionale dhe të depolitizuar, që e vë qytetarin në qendër të çdo vendimmarrjeje. Synimi ynë është të ndërtojmë një shërbim civil që funksionon mbi meritokraci, transparencë dhe efikasitet, i mbështetur në digjitalizim të plotë dhe integritet të palëkundur institucional. Përmes reformës së thellë dhe investimit në kapacitete njerëzore, administrata publike do të shndërrohet në motor të qeverisjes së mirë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe rindërtimit të besimit publik.

16.1 Digjitalizimi i plotë i shërbimeve publike.

Të gjitha shërbimet publike do të kalojnë në formë digjitale për të garantuar transparencë dhe akses të barabartë për qytetarët. Platforma unike e-shërbimeve do të integrojë institucionet dhe bazat e të dhënave për efikasitet më të lartë. Digjitalizimi redukton kostot, burokracinë dhe rrit besueshmërinë në administratë.

16.2 Depolitizimi i administratës publike.

LDK do të eliminojë ndikimet politike në punësim dhe menaxhim, duke garantuar integritet dhe profesionalizëm në shërbimin civil. Sistemi i rekrutimit do të bazohet ekskluzivisht në kriteret meritokracie dhe transparence. Kjo qasje forcon pavarësinë institucionale dhe rrit eficiencën e administratës.

16.3 Reforma ligjore për shërbimin civil.

Përditësimi i legjislacionit do të garantojë stabilitet të karrierës civile, procedura të qarta avancimi dhe mbrojtje profesionale për shërbyesit civilë. Ligjet e reja do të synojnë efikasitet, integritet dhe standardizim të punës në administratë. Kjo reformë e bën administratën më të drejtë dhe më funksionale.

16.4 Korniza e performancës dhe vlerësimit të stafit.

Do të vendosim një sistem modern për matjen e performancës, të lidhur drejtpërdrejt me avancimet dhe motivimin e stafit. Ky mekanizëm rrit përgjegjësinë dhe nxit përmirësimin e vazhdueshëm të punës. Standardet e qarta të performancës e bëjnë administratën më efikase dhe më të orientuar drejt rezultateve.

16.5 Profesionistët e rinj në administratë – “Talent Program”.

Programi i Talenteve do të sjellë në administratë të rinj të aftë dhe të motivuar, përmes një konkursi me kriteret e rrepta profesionale. Qëllimi është rinovimi i administratës me kapacitete shtesë dhe energji të reja. Ky mekanizëm krijon një bazë të qëndrueshme për lidërshtipin e ardhshëm institucional.

16.6 Specializimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i shërbyesve civilë.

Shërbyesit civilë do të kenë qasje në programe të rregullta trajnimi, të përafruara me standardet evropiane të administrimit publik. Investimi në trajnime krijon një administratë më profesionale dhe më të aftë për të përballuar sfidat moderne. Kjo rrit cilësinë e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

16.7 Menaxhimi modern i burimeve njerëzore.

LDK do të vendosë praktika bashkëkohore të HR-it në institucionet publike për organizim më efikas dhe menaxhim të drejtë të personelit. Sistemet e reja do të mbështesin planifikimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e karrierës. Qasja profesionale në HR është thelbësore për një administratë performante.

16.8 Thjeshtimi i procedurave administrative.

Procedurat administrative do të standardizohen dhe thjeshtohen për të ulur burokracinë dhe për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në shërbime publike. Eliminimi i hapave të panevojshëm rrit shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve dhe redukton kostot. Qytetari vendoset në qendër të procesit administrativ.

17 QEVERISJA LOKALE PUBLIKE

Qeverisja lokale është themeli i shtetit funksional; aty ku qytetari e ndien më parë dhe më drejtpërdrejt dorën e institucioneve. LDK beson se komunat tona duhet të jenë motorë të zhvillimit, laboratorë të inovacionit dhe pika të para të besimit publik. Vizion i ynë është të ndërtojmë një pushtet lokal modern, transparent dhe të fuqizuar financiarisht, që ofron shërbime të barabarta dhe dinjitoze për secilin qytetar, në çdo cep të vendit. Përmes digjitalizimit, decentralizimit të përgjegjësive dhe forcimit të kapaciteteve profesionale, komunat do të shndërrohen në partnerë të vërtetë të qeverisjes kombëtare dhe motorë të zhvillimit të balancuar territorial.

17.1 Reforma e financave lokale.

Rritja e buxhetit për komunat dhe krijimi i mekanizmave të rinj fiskalë forcon autonominë financiare dhe aftësinë e tyre investuese. Reforma synon shpërndarje më të drejtë të fondeve dhe rritje të transparencës në menaxhimin buxhetor. Kjo u mundëson komunave të planifikojnë dhe zbatojnë projekte që i përgjigjen realisht nevojave të qytetarëve.

17.2 Grantet për investime kapitale në komuna.

Komunave do t'u dedikohen fonde të veçanta për projekte infrastrukture dhe zhvillimore me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës. Grantet do të shpërndahen mbi kritere të qarta, transparente dhe të matshme. Kjo nxit konkurrueshmërinë komunale dhe përmirëson planifikimin afatgjatë.

17.3 Digjitalizimi i shërbimeve komunale.

Shërbimet kryesore komunale do të transformohen në platforma digjitale për t'i bërë më të shpejta, më të aksesueshme dhe më transparente për qytetarët. Digjitalizimi ul kostot administrative dhe redukton burokracinë. Kjo krijon standard të ri të efikasitetit në qeverisjen lokale.

17.4 Hartimi i planeve lokale të zhvillimit.

Çdo komunë do të hartojë plane të detajuara zhvillimore ekonomike, sociale dhe mjedisore, të bazuara në nevojat reale të territorit. Këto plane do të orientohen nga të dhënat dhe analizat profesionale të kapaciteteve lokale. Kjo qasje siguron zhvillim të balancuar dhe rrit përgjegjësinë institucionale.

17.5 Shërbime më të mira për qytetarët.

Cilësia e shërbimeve komunale do të rritet përmes standardizimit, monitorimit të rregullt dhe trajnimit të stafit. Qytetarët do të përfitojnë shërbime më të shpejta, më profesionale dhe të njëjta në të gjitha komunat. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shërbimeve sociale, pastrimit urban dhe menaxhimit të hapësirave publike.

17.6 Transparenca dhe llogaridhënia në komuna.

Mekanizmat e mbikëqyrjes, publikimit të të dhënave dhe raportimit financiar do të forcohen dukshëm për të parandaluar keqpërdorimet. Qytetarëve do t'u mundësohet qasje më e gjerë në informacionet komunale dhe proceset vendimmarrëse. Kjo rrit besimin dhe siguron qeverisje të përgjegjshme.

17.7 Profesionalizimi i administratës komunale.

Stafi komunal do të trajnohet dhe specializohet në menaxhim, planifikim dhe ofrim të shërbimeve për të arritur standarde evropiane të administratës lokale. Komunat do të adoptojnë praktika moderne të HR-it dhe sistemet e performancës. Kjo përforcon kapacitetet institucionale dhe rrit efikasitetin.

17.8 Bashkëpunimi ndërkomunal.

Komunat do të inkurajohen të zhvillojnë projekte të përbashkëta në infrastrukturë, ekonomi, mjedis dhe shërbime publike, si mënyrë për të rritur efektivitetin dhe ulur kostot. Bashkëpunimi rajonal krijon sinergji zhvillimore dhe ndihmon në koordinimin territorial. Kjo qasje e forcon nivelin lokal si aktor kyç në zhvillimin kombëtar.

18 MËRGATA

Mërgata është zgjerimi i natyrshëm i Republikës jashtë kufijve të saj; është forca jonë ekonomike, sociale dhe kulturore që e ka mbajtur gjallë shtetin në ditë të vështira dhe që sot mbetet partneri ynë më strategjik për zhvillimin e vendit. LDK njeh rolin historik dhe potencialin e jashtëzakonshëm të mërgatës dhe synon të krijojë ura të reja të bashkëpunimit me ta, duke modernizuar shërbimet, forcuar identitetin kulturor dhe hapur mundësi reale për integrim ekonomik e institucional. Me këtë vizion, mërgata shihet jo vetëm si komunitet jashtë vendit, por si pjesë aktive dhe vendimtare e së ardhmes së Kosovës.

18.1 Forcimi i shërbimeve konsullore.

Shërbimet konsullore do të modernizohen dhe digjitalizohen për të ofruar qasje më të shpejtë, më profesionale dhe më transparente për qytetarët tanë jashtë vendit. Përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe stafore do të rrisë cilësinë e përgjigjes institucionale. Qasja synon eliminimin e burokracisë dhe ofrimin e mbështetjes së menjëhershme për mërgatën.

18.2 Platforma unike për mërgatën.

Do të krijohet një platformë e integruar digjitale që lidh qytetarët jashtë vendit me institucionet e Kosovës përmes shërbimeve, informimit dhe komunikimit të drejtpërdrejtë. Kjo platformë do të shërbejë si dritare unike për të gjitha procedurat konsullore dhe administrative. Synimi është krijimi i një kanali të qëndrueshëm, funksional dhe miqësor për mërgatën.

18.3 Angazhimi ekonomik i mërgatës.

LDK do të krijojë instrumente të posaçme për të nxitur investimet e mërgatës përmes lehtësimeve fiskale, fondeve të përbashkëta dhe skemave të garancisë. Mërgata do të ketë mundësi më të mira për të investuar në sektorë strategjikë dhe për të hapur vende të reja pune. Synimi është shndërrimi i potencialit financiar të mërgatës në motor zhvillimi për ekonominë tonë.

18.4 Arsimi dhe gjuha shqipe në mërgatë.

Programi synon mbështetjen e shkollave shqipe, trajnimin e mësimeve dhe sigurimin e materialeve didaktike të standardizuara. Përmes këtyre masave, ruhet gjuha, identiteti dhe lidhja emocionale e brezave të rinj me Kosovën. Prioritet mbetet krijimi i kushteve të qëndrueshme për mësimin plotësues në diasporë.

18.5 Diplomacia kulturore me mërgatën.

Artistët, komunitetet dhe shoqatat e mërgatës do të përfshihen në promovimin ndërkombëtar të kulturës kosovare. Mbështetja institucionale do të forcojë rolin e tyre si ambasadorë të vlerave tona kulturore. Kjo qasje e shndërron diasporën në një rrjet të fuqishëm të diplomacisë së butë të vendit.

18.6 Përfaqësimi i mërgatës në institucionet e Kosovës.

LDK synon hartimin e mekanizmave të rinj që rrisin pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e mërgatës në institucionet vendore dhe proceset vendimmarrëse. Kjo përfshin kanale konsultimi, këshilla këshillimore dhe modele të përfaqësimit formal. Objektivi është që zëri i mërgatës të jetë i pranishëm në politikëbërjen kombëtare.

18.7 Mbrojtja e të drejtave të mërgatës.

Shërbimet ligjore dhe mekanizmat mbrojtës do të zgjerojnë kapacitetin e shtetit për të reaguar ndaj abuzimeve dhe diskriminimit të mërgimtarëve. Konsullatat do të pajisen me mjete të reja mbrojtjeje dhe këshillimi. Qeveria do të punojë për standarde më të larta sigurie dhe dinjiteti për qytetarët jashtë vendit.

18.8 Bashkëpunimi me shtetet pritëse.

Bashkëpunimi me vendet ku jeton mërgata do të thellohet në fusha si puna, pensionet, edukimi dhe integrimi social. Marrëveshjet bilaterale do të forcojnë pozicionin juridik dhe social të mërgimtarëve. Synimi është krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt jetësor për ta në vendet ku jetojnë.

19 TREGTIA DHE INDUSTRIJA

Industria është motori që i jep ritëm zhvillimit ekonomik, ndërsa tregtia është ura që e lidh prodhimin vendor me botën. LDK ka prioritet të qartë forcimin e kapaciteteve prodhuese, rritjen e konkurrueshmërisë dhe krijimin e një ekonomie që prodhon më shumë, eksporton më shumë dhe i mbron më mirë interesat e tregut të brendshëm. Përmes politikave mbështetëse, standardizimit, inovacionit dhe digjitalizimit, synimi ynë është që bizneset vendore të kenë kushte të qëndrueshme për rritje, investime dhe zhvillim afatgjatë. Ky vizion e vendos industrinë në qendër të transformimit ekonomik të Kosovës.

19.1 Strategjia Industriale Kombëtare.

Do të hartohet një strategji e plotë industriale që përcakton sektorët prioritarë dhe instrumentet mbështetëse për secilin prej tyre. Kjo strategji do të orientojë investimet dhe politikat qeveritare për të krijuar një bazë të fortë prodhimi. Qasja synon të rrisë kapacitetet e industrisë dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm.

19.2 Mbrojtja e prodhimit vendor.

LDK do të vendosë masa të përkohshme mbrojtëse kundër produkteve të importuara që dëmtojnë industrinë e brendshme, në përputhje me rregullat e tregtisë ndërkombëtare. Prioritet mbetet mbështetja e prodhuesve vendorë në fazat kritike të zhvillimit. Kjo politikë krijon kushte të barabarta konkurrimi dhe nxit prodhimin vendas.

19.3 Zonat industriale të standardizuara.

Do të ndërtohen dhe standardizohen zona industriale të pajisura me infrastrukturë të plotë energjetike, logjistike dhe teknologjike. Këto zona ulin kostot për bizneset prodhuese dhe përshpejtojnë proceset e investimit. Standardizimi garanton kushte të njëjta dhe konkurruese për të gjitha ndërmarrjet.

19.4 Lehtësimi i procedurave për tregti.

Procedurat doganore, licencimi dhe dokumentacioni administrativ do të thjeshtohen dhe përshpejtohen për eksportuesit dhe importuesit. Qëllimi është ulja e kohës së pritjes dhe kostove të transaksioneve. Kjo krijon një mjedis tregtar më efikas dhe konkurrues për bizneset kosovare.

19.5 Standardizimi dhe cilësia e produkteve.

Kapacitetet laboratorike dhe certifikuese do të forcohen për të garantuar cilësi më të lartë dhe siguri të produkteve në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar. Prodhuesit do të mbështeten për të përmbushur standardet e BE-së. Kjo rrit besueshmërinë e produkteve kosovare dhe lehtëson eksportin.

19.6 Qendrat për inovacion dhe teknologji në industri.

Do të krijohen qendra inovacioni që mbështesin automatizimin, robotizimin, transformimin digjital dhe zhvillimin e teknologjive të reja industriale. Bizneset do të kenë qasje në ekspertizë dhe pajisje moderne për të përmirësuar proceset e tyre. Synimi është krijimi i industrisë së gjeneratës së ardhshme në Kosovë.

19.7 Politikat për eksportet.

Qeveria do të zbatojë politika nxitëse që u mundësojnë eksportuesve qasje në tregje të reja ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve tregtare, fondeve mbështetëse dhe promovimit të markës “Made in Kosovo”. Prioritet mbetet diversifikimi i destinacioneve tregtare. Kjo e rrit qëndrueshmërinë ekonomike dhe hap mundësi të reja për bizneset vendore.

19.8 Mbështetja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

NVM-të do të mbështeten përmes skemave të garancive kreditore, granteve për teknologji dhe modernizim, si dhe trajnimeve për menaxhim. Qasja synon rritjen e konkurrueshmërisë dhe kapaciteteve të tyre prodhuese. NVM-të mbeten shtylla kryesore e ekonomisë kosovare dhe meritojnë mbështetje të drejtpërdrejtë.

19.9 Regjistri i zinxhirit të furnizimit.

Do të krijohet një regjistër kombëtar që lidh prodhuesit vendorë me blerësit, furnizuesit dhe distributorët brenda vendit. Ky mekanizëm rrit transparencën dhe zvogëlon varësinë nga importet. Regjistri fuqizon rrjetin industrial dhe rrit efikasitetin e tregut të brendshëm.

19.10 Digjitalizimi i proceseve tregtare dhe industriale.

Procedurat dhe shërbimet në tregti dhe industri do të digjitalizohen për të rritur efikasitetin dhe ulur kohën e transaksioneve. Komunikimi mes institucioneve dhe bizneseve do të bëhet në mënyrë të integruar dhe transparente. Digjitalizimi e bën sistemin më të parashikueshëm dhe lehtëson operimin e ndërmarrjeve.

20 POLITIKA SOCIALE DHE PENSIONALE

Një shtet matet nga mënyra se si kujdeset për më të cenueshmit e tij. LDK paraqet vizionin për një sistem social të drejtë, gjithëpërfshirës dhe financiarisht të qëndrueshëm, që garanton dinjitet për të moshuarit, mbrojtje për familjet në nevojë dhe siguri për ata që përballen me vështirësi të përditshme. Qasja jonë synon modernizimin e skemave sociale, rritjen e pensioneve dhe krijimin e një arkitekture pensionale të ndërtuar mbi standardet evropiane dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. Përmes këtyre reformave, shteti bëhet partner real i qytetarëve në gjithë ciklin e jetës.

20.1 Reforma e skemave të asistencës sociale.

Skemat sociale do të reformohen për të targetuar në mënyrë më efektive familjet dhe individët në nevojë, duke eliminuar abuzimet dhe duke rritur drejtësinë e përfitimit. Mbështetja financiare do të orientohet drejt atyre që realisht kanë nevojë për të. Qasja synon rritjen e ndikimit social të buxhetit dhe garantimin e mbrojtjes minimale për çdo qytetar në rrezik.

20.2 Rritja e pensioneve bazë.

Pensioni bazë do të rritet në mënyrë të ndjeshme, duke garantuar që askush të mos marrë më pak se 200 euro në muaj. Kjo masë synon të përmirësojë cilësinë e jetës së të moshuarve dhe të reduktojë varfërinë në këtë kategori. Rritja trajtohet si investim në dinjitetin njerëzor dhe në një pleqëri më të sigurt.

20.3 Reforma e pensioneve kontributdhënëse.

Sistemi kontributdhënës do të modernizohet për të siguruar stabilitet financiar dhe përputhshmëri me praktikën më të mira evropiane. Reforma synon të rrisë besueshmërinë e skemës dhe të përmirësojë ndikimin e kontributeve në përfitimet finale. Kjo qasje e bën sistemin më të drejtë, më parashikues dhe më të qëndrueshëm.

20.4 Pensionet e invalidëve të punës.

Mbështetja për invalidët e punës do të zgjerohet përmes kriterëve më të drejta, rritjes së pagesave dhe qasjes më të lehtë në shërbime. Synimi është garantimi i një jetese më të qëndrueshme dhe më të dinjitetshme për ata që kanë humbur aftësinë për punë për shkak të rrezikut profesional. Shteti merr rol aktiv në kompensimin e padrejtësive strukturore të së kaluarës.

20.5 Skemat për personat me aftësi të kufizuara.

Të gjitha skemat për PAK do të reformohen me rritje të mbështetjes financiare dhe ofrim të shërbimeve më të integruara dhe më profesionale. Fokus i veçantë do t'i kushtohet aksesit, mobilitetit dhe mbështetjes institucionale. Qëllimi është të krijohet një sistem që e sheh personin me aftësi të kufizuara si qytetar me të drejta të plota, jo si përjashtim social.

20.6 Përmirësimi i mbrojtjes së fëmijëve.

Do të zbatohen programe të reja për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, me fokus në parandalim, ndërhyrje të hershme dhe mbështetje psiko-sociale. Institucionet do të forcojnë kapacitetet për identifikimin e rasteve të abuzimit dhe neglizhencës. Kjo reformë e vendos mirëqenien e fëmijës në qendër të politikave sociale.

20.7 Standardizimi i shërbimeve sociale komunale.

Komunat do të detyrohen të ofrojnë shërbime sociale të standardizuara në gjithë territorin, duke siguruar barazi dhe cilësi të njëjtë në qasjen e qytetarëve. Standardizimi rrit profesionalizmin dhe monitorimin e shërbimeve. Qasja synon shmangien e pabarazive mes komunave dhe ngritjen e nivelit të ofrimit të shërbimeve.

20.8 Reforma e financimit të shërbimeve sociale.

Financimi i shërbimeve sociale do të reformohet për t'u bërë më i drejtë, më transparent dhe i lidhur drejtpërdrejt me performancën e komunave. Komunat që ofrojnë shërbime më të mira do të shpërblehen përmes mekanizmave të financimit të bazuar në rezultate. Kjo rrit efektivitetin dhe e orienton sistemin drejt shërbimeve cilësore dhe të matshme.

21 SEKTORI FINANCIAR

Një ekonomi moderne ndërtohet mbi një sektor financiar të qëndrueshëm, të besueshëm dhe inovativ. LDK paraqet vizionin për një sistem financiar më konkurrues, më të hapur dhe më të lidhur me ekonominë reale, ku qytetarët dhe bizneset përfitojnë nga shërbime më të lira, shpejta dhe më cilësore. Qasja jonë synon forcimin e pavarësisë së Bankës Qendrore, zhvillimin e fondeve investive, modernizimin e pagesave dhe zgjerimin e mundësive të financimit për prodhimin, inovacionin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

21.1 Qendra Kombëtare për Procesimin e Pagesave (QKPP).

Krijohet një qendër kombëtare për procesimin e pagesave që ul ndjeshëm kostot e transaksioneve dhe shmang varësinë nga qendrat ndërkombëtare të Visa/Mastercard. Ky mekanizëm do të përshpejtojë pagesat dhe do të rrisë sigurinë e sistemit financiar. QKPP bëhet baza e një infrastrukture moderne pagese, në përputhje me standardet evropiane.

21.2 Ligji për Fondet Investive.

Do të hartohet një ligj i ri që mundëson krijimin e fondeve investive si alternativë e rëndësishme financimi për kompani dhe individë. Kjo u jep bizneseve mundësinë të marrin kapital përtej bankave dhe i ofron qytetarëve mjete të reja investimi.

21.3 Sistemi i Pagesave - konkurrencë dhe qasje e re.

Hapet qasja në llogari bankare për institucionet financiare jobankare, fintech-et dhe aktorë të tjerë që rrisin konkurrencën në treg. Kjo qasje mundëson shërbime më të lira, më të shpejta dhe më inovative për qytetarët. Përfshihet edhe mundësia e pranimit të depozitave të kufizuara, duke krijuar një ekosistem financiar më dinamik.

21.4 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK).

FKGK reformohet për të garantuar kredi në sektorët strategjikë si prodhimi, energjia, teknologjia, bujqësia dhe start-up-et. Legjislacioni aktual është tepër konservativ dhe nuk i ndihmon sektorët me potencial rritjeje. Zgjerimi i mandatit e bën FKGK-në instrument kyç për nxitjen e investimeve dhe zgjerimin e prodhimit vendor.

21.5 Tregu i Sigurimeve.

Legjislacioni për sigurimet do të përmirësohet për të rritur cilësinë, transparencën dhe besueshmërinë e shërbimeve. Liberalizimi i tregut pritet të nxisë produkte të reja vullnetare dhe të përmirësojë mbrojtjen e qytetarëve. Reforma synon krijimin e një tregu modern sigurimesh që përmbush standardet e BE-së.



VOTO
123

PROGRAMI QEVERISËS I LIDHJES DEMOKRATIKE TË KOSOVËS

Zgjidh
SHPRESEN!